



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë
Master i Shkencave në “Financë”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
“Kolegji Universitar Qirjazi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Dr. Gentiana Sharku


2. Dr. Valbona Kapllani

Nëntor, 2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Financë” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Qirjazi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Qirjazi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Financë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.274, datë 10.05.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhëri i MAS Nr.92, datë 01.03.2017
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.7, dt.07/01/2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.106, datë 02.11.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 (tetë) PAE / 4 (katër) PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 3 (nëntë) studentë; 2020-2021 9 (nëntë) studentë; 2021-2022 9 (nëntë) studentë.
19	Komente / të tjera:	-





PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Financë” është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Nr. 46, datë 09.02.2012. Ky program ofrohet nga Kolegji Universitar “Qiriazi” i licencuar në vitin 2006, nën emërtimin “Shkolla e Lartë Universitare Jo-publike “Sevasi dhe Parashqevi Qiriazi” dhe i riorganizuar në vitin 2017 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 92, nën emërtimin “Kolegji Universitar Qiriazi”. Programi i Shkencave në “Financë” është akredituar me VBA Nr. 106, datë 02.11.2019 me kohëzgjatjen prej 2 (dy) vite akademike.

Kolegji Universitar është organizuar në katër njësi kryesore në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në katër njësi kryesore:

- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Drejtësisë;
- Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Sportit; dhe
- Kolegji Profesional i Lartë.

Departamenti i Financës i Fakultetit të Ekonomisë është njësi bazë përgjegjëse që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në “Financë”.

Programi Master i Shkencave në “Financë” është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e sferës së financës dhe kontabilitetit. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky master është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Financë”.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike dhe praktike në fushën e financës si manaxhimi i ndërmarrjeve, financa, kontabiliteti, projektimi dhe përdorimi i programeve kompjuterike në fushën e ekonomisë dhe biznesit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 15.02.2022, Kolegji Universitar Qiriazhi ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit Master i Shkencave në "Financë". ASCAL bazuar në *“Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji Universitar Qiriazhi, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr. Gentiana Sharku**, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës dhe **Dr. Valbona Kapllani**, pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Endra Velaj**.

Në datën 28.07.2022 ekspertëve të jashtëm iu dha në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 19 dhe 20 Shtator 2022 në ambientet e Kolegjit Universitar Qiriazhi. Vizitat e ekspertëve u realizuan në sallën e mbledhjeve të vënë në dispozicion për kryerjen e të gjitha takimeve sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datat 27 dhe 30 Shtator 2022.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave në “Financë”.

Në fund paraqiten rekomandimet për programin e studimit dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që riakreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.106, datë 02.11.2019 janë:

- 1) Institucioni të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi, me qëllim përfshirjen në të të praktikës profesionale dhe përmirësimin e lëndëve të kategorisë së veprimtarive formuese "D", për t'u plotësuar dhe përshtatur me standardet dhe aktet rregullatore në fuqi.
- 2) Institucioni të marrë masa për të adresuar paqëndrueshmërinë e stafit akademik.
- 3) Institucioni të zbatojë e dokumentojë në mënyrë të rregullt procesin e rekrutimit të stafit akademik.
- 4) Institucioni të rrisë mbështetjen e tij, edhe financiare, për aktivitetet kërkimore shkencore të stafit akademik të këtij programi studimi.
- 5) Institucioni të sigurojë që Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të jetë funksionale e të ketë rol aktiv në sigurimin e përmirësimin e cilësisë.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni


- 1) Institucioni të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi, me qëllim përfshirjen në të të praktikës profesionale dhe përmirësimin e lëndëve të kategorisë së veprimtarive formuese "D", për t'u plotësuar dhe përshtatur me standardet dhe aktet rregullatore në fuqi.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është *përmbushur pjesërisht*. Sikurse raportohet në RVB dhe në vendimin Nr.17/1, datë 09.12.2019 të Senatit të KUQ, në planin mësimor të programit të studimit "Master i Shkencave në Financë" është përfshirë tashmë praktika profesionale me 12 kredite, është bërë një rishpërndarje kreditesh në lëndën "Financa Ndërkombëtare" dhe "Detyrime Përmbyllëse -Temë Diplome", si dhe programet e lëndëve (syllabuset) janë formatuar sipas elementëve të kërkuar nga kuadri rregullator në fuqi.

Megjithatë, GVJ gjykon se ndryshimet e ndodhura në planin mësimor të këtij programi studimi kundrejt planit mësimor të vitit akademik 2018-2019, objekt i akreditimit të parë, janë më të mëdha sesa ato të deklaruara në RVB dhe të miratuara nga vendimi përkatës i Senatit të KUQ. Gjithashtu, në dokumentacionin e planit të ri mësimor ka pasaktësi në shpërndarjen e krediteve mes lëndëve, si dhe përfshirja e lëndëve në kategorinë B (karakterizuese) dhe C (ndërdisiplinore/integruese) rezulton subjektive, nuk mban parasysh natyrën/përmbajtjen e lëndës.

- 2) Institucioni të marrë masa për të adresuar paqëndrueshmërinë e stafit akademik.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është *përmbushur kryesisht*. Sikurse raportohet edhe në RVB në dy vitet e fundit, pranë këtij programi studimi është angazhuar pothuajse i njëjti grup pedagogësh (personel akademik efektiv dhe me kontratë). Por, GVJ konstaton se kuadri rregullator i institucionit parashikon që kontratat e punësimit edhe për personelin akademik me grada e tituj të jenë me afat, me të drejtë përsëritje. Në kushtet kur aktualisht numri i anëtarëve të departamentit është sa limiti i lejuar nga legjislacioni në fuqi (7 anëtarë dhe vetëm 3 me grada dhe tituj) GVJ



vlerëson se institucioni është i ekspozuar ndaj rrezikut të mospërbushjes së detyrimit ligjor në rast të largimit të njerit prej anëtarëve aktualë të departamentit (efektiv).

- 3) Institucioni të zbatojë e dokumentojë në mënyrë të rregullt procesin e rekrutimit të stafit akademik.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**. Në takimin me përfaqësuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivës, u konstatua se tashmë pranë institucionit ndiqej një proces rekrutimi dhe përgjithësisht dokumentacioni përmbante të gjithë elementët e parashikuar nga kuadri rregullator. Nga verifikimi rastësor i dy dosjeve të personelit akademik dhe i një praktike rekrutimi u konstatua se kontratat përkatëse të punësimit ishin njëvjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje dhe nuk rezultuan të përditësuara.

- 4) Institucioni të rrisë mbështetjen e tij edhe financiare, për aktivitetet kërkimore shkencore të stafit akademik të këtij programi studimi.


GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**. Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e personelit akademik në aktivitete mësimore & kërkimore si dhe të institucionit në funksion të rritjes së mbështetjes financiare përmes investimit në paisje dhe vendosjes së një fondi të veçantë për kërkimin shkencor për vitin akademik 2021-2022. Megjithatë, duke i'u referuar aktiviteteve kërkimore – shkencore të raportuara për periudhën kohore 2019-2022 nga pedagogët e Departamentit të Financës, GVJ gjykon se mbështetja financiare e dhënë apo e përdorur është në nivele modeste.

- 5) Institucioni, të sigurojë që Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të jetë funksionale dhe të ketë rol aktiv në sigurimin e përmirësimit e cilësisë.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**. Sikurse raportohet në RVB është përmirësuar aktiviteti i Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe funksionimi i saj, por GVJ konstaton se ka ende vend për përmirësim pasi raportet e kësaj njësie janë përgjithësisht përshkruese të veprimtarisë dhe nuk shoqërohen me një analizë të gjetjeve (pikave të dobëta dhe të forta) si dhe me masa të sugjeruara për përmirësim të situatës. Fokusi i aktivitetit të NJSBC është kryesisht monitorimi i ecurisë dhe raportet e përgatitura u komunikohen drejtpërdrejt vetëm strukturave drejtuese të institucionit. GVJ konstatoi se raportet e kësaj njësie nuk publikohen. Personeli akademik dhe studentët informohen në mënyrë indirekte.

Më datë 24/10/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.90/16 prot, datë 24/10/2022 dërgohet në Institucion Draft-Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 28.10.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr.176 Prot, datë 28.10.2022.

GVJ pasi u njoh me komentet e bëra nga Kolegji Universitar “Qirjazi” (në vijim shkurt KUQ) lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm sqaron si më poshtë:



Komentet lidhur me plotësimin e rekomandimeve të Intitucionit:

2. Institucioni, të marrë masa për të adresuar paqëndrueshmërinë e stafit akademik.

Duke j'u referuar komenteve "a" dhe "b" të dhënë nga institucioni për këtë çështje, GVJ vlerëson angazhimin e KUQ për adresimin e këtij rekomandimi. Megjithatë, vlerësimi i dhënë nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion. GVJ konstatoi se numri i stafit akademik efektiv, aktualisht është në nivelin minimal të kërkuar nga ligji dhe për këtë arsye nuk mund të plotësohet me bashkëpunëtorë dhe pedagogë jo-efektive. Gjithashtu, GVJ konstatoi pasaktësi edhe në raportimin e numrit të stafit akademik efektiv për vitin 2021-2022 në Departamentin e Financës dhe në programin e studimit.

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.


Vlerësimi i plotësimit të këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar.

4. Institucioni të rrisë nivelin e mbështetjen e tij financiare për aktivitetet kërkimore shkencore të stafit akademik të këtij program studimi.

Duke j'u referuar komentit "a" të dhënë nga institucioni për këtë çështje, GVJ vlerëson angazhimin e KUQ për adresimin e këtij rekomandimi. Megjithatë, vlerësimi i dhënë nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion. Duke j'u referuar Aneksit 1_19 të dosjes së RVB, GVJ konstatoi se tematikat e konferencave të organizuara nga KUQ apo aktivitetet e tjera shkencore të organizuara ku kanë marrë pjesë stafi akademik i programit të studimit dhe Departamentit të Financës në përgjithësi nuk lidhen me fushën specifike të programit të studimit.

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.

Vlerësimi i plotësimit të këtij rekomandimi mbetet i pandryshuar



Komentet mbi konkluzionet për standardet sipas fushave të programit të studimit:

I. Ofrimi i programit të studimit

Standardi 1.3

Duke j'u referuar komenteve "a" dhe "b" të dhënë nga institucioni në lidhje me *Kriterin 3* dhe *Kriterin 4 të Standardit 1.3*, GVJ vlerëson angazhimin e KUQ për realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësitë e biznesit. Megjithatë, GVJ nuk konstatoi ndonjë evidencë mbi përfitimet konkrete që janë siguruar nga marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset.

Gjithashtu, sikurse jemi shprehur edhe në RVJ, Aneksi 3_14 "Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e ciklit të dytë të stufimeve MASHFIN" i referohet aktiviteteve në kuadër institucioni dhe pjesa më e madhe e pedagogëve, puna kërkimore e të cilëve analizohet në këtë raport, nuk janë pjesë e programit të studimit apo të Departamentit të Financës. Pjesë e këtij raporti është Aneksi 1_19, i cili i referohet stafit akademik të institucionit.

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.

Vlerësimi i plotësimit të këtij standardi mbetet i pandryshuar.

II. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të ciklit të dytë



Standardi II.2

Duke j'u referuar komentit "a" të dhënë nga institucioni në lidhje me *Standardin II.2* sqarojmë se vlerësimi i GVJ është bërë në përputhje me kerkesat e kriterit përkatës, i cili kërkon që koordinatori të përcaktohet për çdo program studimi.

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.

Vlerësimi i plotësimit të këtij standardi mbetet i pandryshuar.

III. Mësimdhënia, mësimxënia, vlerësimi dhe kompetencat

Standardi III.1

Duke j'u referuar komentit "a" të dhënë nga institucioni në lidhje me *Standardin III.1* sqarojmë se në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, GVJ konkludoi se orët në auditor nuk janë realizuar në fakt sipas planit mësimor. Sikurse është shprehur në RVJ "Për çdo lëndë janë parashikuar 60 orë në auditor leksione dhe seminare. Nga shqyrtimi i orarit mësimor të publikuar për vitin akademik 2021-2022, i cili është vënë në dispozicion në bazë të kërkesës së GVJ gjatë vizitës në institucion, rezulton se për çdo lëndë orari parashikonte 12 orë në javë që realizoheshin në katër javë – pra gjithsej 48 orë në auditor".

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.

Vlerësimi i plotësimit të këtij standardi mbetet i pandryshuar.

Standardi III.3

Duke j'u referuar komentit "a" të dhënë nga institucioni në lidhje me *Standardin III.3*, GVJ ka konstatuar bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion, mosplotësimin e kërkesës së standardit lidhur me përdorimin e sistemit elektronik të vlerësimit të studentëve, i cili jo vetëm lehtëson komunikimin dhe menaxhimin e informacionit midis studentëve, stafit administrativ dhe stafit pedagogjik, por siguron dhe transparencë dhe objektivizëm në këtë proces.

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.

Vlerësimi i plotësimit të këtij standardi mbetet i pandryshuar.

Standardi III.5

Duke j'u referuar komentit "a" të dhënë nga institucioni në lidhje me *Standardin III.5*, GVJ është shprehur në raport se procedurat mbi detyrimet përmbyllëse (punimin e diplomës) janë përcaktuar në rregulloret përkatëse. Megjithatë, GVJ vlerëson se udhëzuesi për temën e diplomës nuk mund të jetë i njëjtë edhe për ciklin e parë të studimeve edhe për ciklin e dytë të studimeve sikurse paraqitet në Aneksin 2_10 të dokumentacionit shoqërues, pavarësisht se studimet në nivelin "Bachelor" mund të mbyllet me Provim Formimi.

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.

Vlerësimi i plotësimit të këtij standardi mbetet i pandryshuar.

Standardi IV.1

Duke j'u referuar komenteve "a" dhe "b" të dhënë nga institucioni në lidhje me *Standardin 4.1*, GVJ vlerëson angazhimin e strukturave përkatëse për plotësimin e kërkesave të këtij standardi.

Megjithatë, GVJ në vlerësimin përfundimtar, sikurse u përmend edhe më sipër, është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion.

Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të dhëna nga KUQ.

Vlerësimi i plotësimit të këtij standardi mbetet i pandryshuar.


Si përfundim, GVJ i përmbahet vlerësimeve dhe rekomandimeve që ka dhënë në draft raportin e RVJ.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Financë"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Statuti (neni 3) i Kolegjit Universitar "Qirjazi" (shkurt KUQ) i hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe i miratuar me vendim të Senatit Akademik në vitin 2017 dhe Plani Strategjik (pika 1.4) përcaktojnë qartë vizionin dhe misionin e KUQ që të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit nëpërmjet programeve të studimit të ofruar nga ky institucion. Roli dhe misioni i KUQ, bazuar në dokumentacionin e institucionit, është që t'u ofrojë studentëve jo vetëm një edukim cilësor akademik por edhe

	<p>të kontribuojë në edukimin e vlerave qytetare dhe demokratike të shoqërisë shqiptare.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave Financë”, mbështetur në Statutin dhe Planin Strategjik të KUQ, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p><i>Referenca: An._1_1 “Statuti i KUQ”; An._1_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar Qirjazi”]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” përcakton si mision të tij përgatitjen e studentëve me formim të shëndoshë profesional e social, të aftë t’u paraprijnë zhvillimeve të shpejta ndërkombëtare në përgjithësi, por veçanërisht të përshtatin e orientojnë zhvillimet në shoqërinë dhe ekonominë e vendit tonë, në përputhje me planin strategjik të KUQ. Referuar dokumentacionit, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” përputhet me fushën e veprimtarisë së institucionit si edhe me qëllimet dhe misionin e tij.</p> <p><i>[Referenca: An._1_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të kolegjit Universitar Qirjazi”; An._3_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit MSHFIN”]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi “Master i Shkencave në Financë” është një program studimi i ciklit të dytë të studimeve i hartuar në përputhje me rregulloren e institucionit (neni 35, 36) dhe të njësisë kryesore (neni 5) dhe Planin strategjik të institucionit (pika 2.2), që synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi për kërkim shkencor në fushën e financës. Në përputhje me Statutin (neni 3), programi i studimit ka për qëllim zhvillimin e dijeve dhe përgatitjen e studentëve në nivel bashkëkohor nëpërmjet aktiviteteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Programi i studimit synon të përgatitë specialistë të aftë dhe të kualifikojë kandidatë për kërkim shkencor në fushën e financës në përputhje me fushat akademike të Institucionit dhe Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>[Referenca: An._1_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar Qirjazi”; An._3_4 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; Evidenca shitesë nr. 24 “Fushat kryesore të njësisë kryesore dhe bazë”]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit,</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në dokumentet bashkëngjitur RVB (si Plani strategjik i institucionit - pika 1.4), programet e ofruara nga KUQ synojnë të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe</p>



interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	kombëtare; të ndërkombëtarizojnë insitucionin në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; si dhe të zhvillojë veprimtarinë akademike në përputhje me standardet e Komunitetit Evropian, në mbështetje të interesave strategjikë dhe interesave të zhvillimit të vendit.			
	[Referenca: An_1_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të kolegjit Universitar Qirjazi”]			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave në Financë”: - është hartuar në përputhje me interesin dhe strategjinë kombëtare të zhvillimit; - synon të ruajë dhe konsolidojë vlerat kulturore dhe kombëtare të shoqërisë; dhe - ofrohet në përputhje me misionin, Statutin dhe Strategjinë e Institucionit dhe me fushat e studimit të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Kolegji Universitar “Qirjazi” i ka fillesat e tij me Shkollën e Lartë Universitare Jo-publike “Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi” e licencuar në vitin 2006. Në vitin 2017, me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 92, institucioni është riorganizuar duke u emërtuar Kolegji Universitar Qiriazi. Në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015, KUQ është organizuar në katër njësi kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fakulteti i Ekonomisë; ▪ Fakulteti i Drejtësisë; ▪ Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Sportit; dhe ▪ Kolegji Profesional i Lartë. <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë i përbërë nga tre departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Financës; ▪ Departamenti i Menaxhim Biznesit; dhe ▪ Qendra Kërkimore-Shkencore. <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, gjatë vitit 2021-2022, pranë Fakultetit të Ekonomisë janë angazhuar gjithsej 30 pedagogë nga të cilët: 21 personel akademik efektiv (PAE) dhe 9 personel akademik me kontratë (PAK).</p>			
	2021-2022	PAE	PAK	Totali

Profesor	3	2	5
Profesor i Asociuar	1	3	4
Doktor/Docent	6	2	8
Msc.	11	2	13
Totali	21	9	30

Secili departament plotëson numrin minimal prej shtatë anëtarësh personel akademik efektiv, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015. Departamenti i Financës është njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”. Departamenti i Financës mbulon tre programe studimi:

- Bachelor në “Financë” në ciklin e parë të studimeve; si dhe
- “Master i Shkencave në Financë” dhe “Master Profesional në Financë”, në ciklin e dytë të studimeve.

[Referenca: An._2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An._2_6 “Stafi Akademik sipas Departamenteve të FE, 2021-2022”]

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” synon të përgatisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi praktike për tregun e punës në fushën e financës. Fusha e këtij programi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe të institucionit: manaxhimi i ndërmarrjeve, financa, kontabiliteti, projektimi dhe përdorimi i programeve kompjuterike në fushën e ekonomisë dhe biznesit, të përcaktuar në rregulloren e FE (neni 16).

Programi i studimit është organizuar dhe klasifikuar sipas kornizës europiane/shqiptare të kualifikimeve dhe udhëzimeve të tjera kombëtare dhe evropiane.

[Referenca: An._2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An._3_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit MSHFIN”; Evidenca shitesë nr. 24 “Fushat kryesore të njësisë kryesore dhe bazë”]


Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë

Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” ofrohet nga Departamenti i Financës i Fakultetit të Ekonomisë të KUQ. Programi i studimit përmban lëndë/module me karakter profesional që synojnë të japin njohuri të plota teorike dhe praktike në fushën e financës, e cila është edhe fusha e përgjithshme akademike dhe kërkimore e Departamentit të Financës si njësi bazë që ofron programin e studimit.

Ky program studimi ofrohet vetëm nga Departamenti i Financës të Fakultetit të Ekonomisë të KUQ – nuk është program ndërdisiplinor.

Ndërkohë që rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë (neni 16) përcakton si fusha akademike të njësisë kryesore “manaxhimin e ndërmarrjeve,

<p>bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>financën, kontabilitetin, projektimin dhe përdorimin e programeve kompjuterike në fushën e ekonomisë dhe biznesit”, rregullorja e Departamentit të Financës (neni 12) përcakton si fushë studimi të departamentit vetëm financën.</p> <p>Me kërkesë të GVJ gjatë vizitës në institucion, u evidentuan fushat e studimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Financës. GVJ rekomandon që rregulloret përkatëse të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Financës të përcaktojnë qartë dhe saktë fushën akademike të përgjithshme dhe specifike të secilës njësi.</p> <p><i>[Referenca: An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit MSHFIN”]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>KUQ është licencuar për ofrimin e kurseve profesionale në fushën e financës dhe kontabilitetit për njësitë e biznesit.</p> <p>Institucioni ka organizuar simpoziume, workshop-e dhe tryeza të rrumbullakta për të bashkëbiseduar me biznese dhe institucione lidhur me nevojat dhe problematikat në fushën e biznesit dhe financës. Dokumentacioni shoqërues i RVB nuk përmban evidenca mbi trajnime apo kualifikime profesionale për studentë të diplomuar. Gjatë takimit me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit, GVJ iu konfirmua se është zhvilluar një trajnim për problemet e fiskalizimit dhe informatizimit në biznes.</p> <p>GVJ rekomandon që, pavarësisht numrit të vogël të studentëve të diplomuar, institucioni të angazhohet konkretisht në ofrimin e trajnimeve profesionale, veçanërisht në fushën e financës.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_19 “Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUË; An. 3_20 “Licensa e KUË për kurse kualifikimi në Financë”]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - KUQ ka në përgjithësi kapacitetet e duhura për ofrimin e programit të studimit. - Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” është në përputhje me fushën e përgjithshme akademike të njësisë kryesore dhe bazë, por rregulloret e këtyre njësive duhet të përcaktojnë qartë dhe në hollësi fushën akademike të tyre.



	- KUQ ofron trajnime profesionale, por nuk ka ndonjë evidencë mbi takimet/trainimet me studentë të diplomuar dhe punëdhënësit e tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Statuti dhe rregulloret përkatëse të institucionit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse të programit të studimit, përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë midis njësive dhe anëtarëve të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Stafi akademik përveç punës mësimore dhe kërkimore, ngarkohet edhe me detyra administrative.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, GVJ iu konfirmua se Fakulteti i Ekonomisë (FE) dhe Departamenti i Financës kryejnë analiza mbi mësimdhënien dhe aktivitetin kërkimor shkencor të personelit akademik. Institucioni përpiqet që të nxisë bashkëpunimin midis njësive dhe anëtarëve të stafit akademik nëpërmjet organizimit të konferencave, seminareve, tryezave të rumbullakta dhe aktiviteteve të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore.</p> <p>[Referenca: An. 1_1 "Statuti i KUQ"; An. 2_3 "Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë"; An. 2_14 "Analiza Vjetore e Fakultetit të Ekonomisë. Viti akademik 2020-2021"]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe krijimi i një partneriteti të qëndrueshëm me institucione publike, private, biznesin, shoqërinë civile dhe grupe të tjera të interesit është një nga prioritetet e veprimtarisë së KUQ, e përcaktuar në Statut dhe në aktet rregullatore të institucionit, me qëllim realizimin sa më mirë të misionit të tij. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, KUQ ka lidhur 19 marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe 39 marrëveshje bashkëpunimi me njësi biznesi.</p> <p>[Referenca: An. 1_1 "Statuti i KUQ"; An. 1_8 "Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit"]</p>

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara mes KUQ dhe njësisve të biznesit janë lidhur kryesisht në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, por edhe për t'u siguruar studentëve mundësi punësimi, për zhvillimin e leksioneve të hapura, workshope-ve apo projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme për realizimin e kërkimit shkencor dhe mobilitetin e personelit akademik në tërësi të institucionit.</p> <p>GVJ rekomandon që këto marrëveshje të përdoren më shumë lidhur me aktivitetin kërkimor-shkencor dhe mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_8 "Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit"; An. 1_19 "Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ"]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Financës merr në analizë zbatimin dhe realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit gjatë mbledhjeve dhe analizave vjetore të departamentit dhe përgjegjësi i departamentit harton një raport të veçantë mbi përfitimet e realizuara nga marrëveshjet e lidhura. Përveç qëllimit kryesor, që është mundësimi i praktikës profesionale për studentët, përfitimet nga marrëveshjet lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillimin e aktiviteteve shkencore si konferenca, forume shkencore, leksione të hapura etj; • realizimin e objektivave mësimorë, përmirësimin e planit mësimor dhe syllabuseve; • shkëmbimin e pedagogëve me IAL e tjera, etj. <p>GVJ rekomandon që këto analiza dhe raporte të fokusohen më shumë në përfitimet që kanë studentët dhe stafi akademik i departamentit të Financës dhe jo Fakulteti Ekonomik në tërësi.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_14 "Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e ciklit të dytë të studimeve MSHFIN"; An. 3_5 "Analiza Vjetore e Departamentit të Financës 2020-2021"]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se</p> <ul style="list-style-type: none"> - KUQ ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione publike dhe private të cilat janë përdorur më shumë në funksion të realizimit të praktikës profesionale të programit të studimit, por jo në funksion të aktivitetit kërkimor-shkencor dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi. - KUQ harton raporte të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, por ato duhet të jenë të fokusuar për Departamentin e Financës dhe programin e studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit “Master i Shkencave në Financë”, GVJ konstaton se programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe module, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Gjithsej ky program studimi ka në total 120 ECTS dhe është i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015.</p> <p>Programi i studimit zgjat dy vite akademike dhe zhvillohet në katër semestra: në secilin prej tre semestrave të parë zhvillohen pesë lëndë (pra në total 15 lëndë) dhe semestrin e katërt zhvillohet praktika profesionale dhe mbrohet tema e Diplomës.</p> <p>GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr 879.</p> <p>Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion, plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” është ndryshuar në vitin akademik 2019-2020 në përmbushje të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit. Në fakt, GVJ konstatoi (sikurse është shpjeguar më poshtë) se ky program është ndryshuar në vitin akademik 2020-2021.</p> <p><i>[Referenca: An_3_4 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An_3_9 “Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An_3_9_2 “Programi Mësimor i lëndëve MSHFIN, 2021-2022”]</i></p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Neni 4 i rregullores së programit të studimit përcakton si qëllim të këtij programi “përgatitjen dhe kualifikimin e kandidatëve për kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese në kontekstin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe njëherësh në përputhje me tregun e punës”, i cili është një qëllim shumë i përgjithshëm dhe nuk është i specifikuar për programin e studimit.</p> <p>Duke shqyrtuar planin mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” ofron njohuri mbi disiplina të ndryshme jo-financiare si ekonomiks, menaxhim, ekonometri, marketing, por edhe njohuri mbi disiplina tërësisht financiare si drejtim financiar, tregje financiare, institucione financiare, taksim, kontabilitet etj., duke synuar një formim të larmishëm dhe shumëdisiplinor për studentët.</p> <p>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit synojnë t’u japin studentëve njohuri dhe aftësi të avancuara të nevojshme për hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës apo thellimin e njohurive akademike nëpërmjet studimeve pasuniversitare.</p> <p>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit shprehet në mënyrë të përgjithshme pa përcaktuar në mënyrë të qartë fushat e specializimit të studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p>GVJ sugjeron që rregullorja e programit të studimit të specifikojë qartë fushën akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit, si dhe pozicionet/tregun e punës, të cilit i drejtohen studentët që diplomohen në këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_4 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An. 3_9 “Plani Mësimor i lëndëve Master në Financë, 2021-2022”; An. 3_10 “Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022”]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”, përmban kryerjen e një praktike profesionale të klasifikuar në kategorinë D me 12 kredite dhe mbrojtjen e Diplomës si formë e detyrimeve përmbyllëse e klasifikuar në kategorinë E me 18 kredite. Klasifikimi sipas veprimtarisë dhe përcaktimi i krediteve është në përputhje me VKM Nr. 41. Për praktikën profesionale dhe diplomën numri i orëve mësimore është 25 orë për një kredit.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9 “Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An. 3_10 “Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022”]</i></p>

<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet, sepse programi në shqyrtim nuk është program studimi i ciklit të dytë “Master” në Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet, sepse programi në shqyrtim nuk është program studimi i ciklit të dytë “Master” në Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet, sepse KUQ nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.</p>

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programe studimi të ciklit të dytë master në fushën e financës ofrohen edhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit. KUQ ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të IAL në Shqipëri dhe një pjesë e personelit akademik të programit të studimit janë apo kanë qenë pjesë e personelit akademik të këtyre institucioneve, të cilët kanë dhënë opinionet e tyre mbi hartimin e planit mësimor dhe sillabuset.</p> <p>Në këtë mënyrë plani mësimor i programit të studimit është hartuar duke u bazuar edhe në kurrikulat që ofrohen nga institucione të tjera të arsimit të lartë dhe GVJ mendon se në tërësinë e tij ky program studimi është i ngjashëm pothuaj në masën 70% - duke konsideruar të gjithë lëndët e planit mësimor (lëndët bazë, karakterizuese, me zgjedhje, praktikën dhe detyrimet përmblyëse) me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi dhe që kanë të njëjtën emërtesë. Por, nëse i referohemi kategorisë së lëndëve karakterizuese, GVJ mendon se kjo përqindje është më e ulët (sikurse e kemi shpjeguar më poshtë në raport).</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabusët e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave në Financë" është program i ciklit të dytë të studimeve që i përket kategorisë të ciklit të dytë master në fushën e financës dhe i përket nivelit shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas Ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve".</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet, sepse programi i studimit "Master i Shkencave në Financë" nuk është i përbashkët me institucione të tjera të arsimit të lartë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit është organizuar në tërësi në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me aktet rregullatore të institucionit. - Objektivat, fusha specifike e studimit dhe e specializimit të programit të studimit duhet të jetë e shprehur në rregulloren e programit të studimit. - Plani mësimor ka ndryshuar në vitin akademik 2021-2022. - Programi i studimit është pothuajse (në tërësi) 70% i ngjashëm me programet e tjera të studimit me të njëjtën emërtesë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë është njësia kryesore dhe Departamenti i Financës është njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar verifikohet se Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës përmbushin detyrimet ligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Ekonomisë është një nga katër njësitë kryesore të KUQ, veprimtaria e të cilit organizohet dhe strukturohet në bazë të kërkesave të legjislacionit të arsimit të lartë, statutit të KUQ dhe rregulloreve të Institucionit dhe Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Financës, ▪ Departamenti i Menaxhim Biznesit dhe ▪ Qendra Kërkimore-shkencore e FE. <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, gjatë vitit 2021-2022, personeli akademik i secilit departament të Fakultetit të Ekonomisë ka përbërjen e mëposhtme:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Departamentet e FE</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Dep. i Financës</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>Dep. i Menaxhim Biznesit</td> <td>7</td> <td>4</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Qendra kërkimore-shkencore</td> <td>7</td> <td>0</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>21</td> <td>9</td> <td>30</td> </tr> </tbody> </table> <p>Secili departament ka numrin minimal të personelit akademik efektiv të kërkuar sipas nenit 35 të Ligjit nr. 80 2015.</p> <p>Departamenti i Financës është njësia bazë përgjegjëse për këto programe studimi: “Bachelor Financë”, “Master i Shkencave në Financë” dhe “Master Profesional në Financë”.</p> <p>Departamenti i Financës ka në përbërjen e tij gjithsej 7 anëtarë si personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët dy anëtarë mbajnë titullin Prof. Dr., një mban gradën shkencore Dr. dhe katër anëtarë mbajnë kualifikimin Msc.</p> <p>Bazuar në evidencën shtesë të vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ gjatë vizitës në institucion, stafi akademik i Departamentit të Financës ka përbërjen e mëposhtme gjatë tre viteve akademikë:</p>	Departamentet e FE	PAE	PAK	Totali	Dep. i Financës	7	5	12	Dep. i Menaxhim Biznesit	7	4	11	Qendra kërkimore-shkencore	7	0	7	Totali	21	9	30
Departamentet e FE	PAE	PAK	Totali																		
Dep. i Financës	7	5	12																		
Dep. i Menaxhim Biznesit	7	4	11																		
Qendra kërkimore-shkencore	7	0	7																		
Totali	21	9	30																		

Departamentet i Financës	PAE	PAK	Totali	Raporti PAE/PAK
2019-2020	7	2	9	78%
2020-2021	7	4	11	64%
2021-2022	7	4	11	64%

Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, numri i personelit akademik me kohë të plotë i Departamentit të Financës është shtatë, sa numri minimal që kërkohet nga Ligji nr. 80 2015, por raporti i personelit efektiv ndaj totalit të personelit akademik ka ardhur në rënie.

Nga shqyrtimi i informacioneve të mësipërme, GVJ konstaton:

- Pasaktësi në raportimin e personelit akademik me kontratë të angazhuar pranë Departamentit të Financës për vitin akademik 2021-2022. Në Aneksin 2_6 raportohen 5 pedagogë me kontratë, ndërsa në dokumentin shtesë Nr. 4 të vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ, raportohen 4 pedagogë me kontratë (ndryshim në numër por edhe në emra).
- Pasaktësi në raportimin e personelit akademik efektiv të angazhuar pranë programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” për vitin akademik 2021-2022. Nga tetë anëtarë të personelit akademik efektiv të raportuar dokumentin shtesë Nr. 3 të vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ, dy prej tyre nuk gjenden në listën e raportuar si personel akademik sipas departamenteve të FE për vitin akademik 2021-2022 në Aneksin 2_6.

Gjithashtu, GVJ konstaton nga tetë anëtarë të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë” vetëm tre prej tyre i përkasin Departamentit të Financës. Kjo vjen për shkak se numri i lëndëve që nuk përputhen me profilin e masterit është i lartë, sikurse shpjegohet në vijim në raport.


GVJ rekomandon që të rritet numri i personelit akademik efektiv në mënyrë që institucioni të mos ketë probleme në burime njerëzore në rast largimi edhe të një pedagogu efektiv, si dhe të rritet mbulimi me personel efektiv dhe lëndë që ofrohen nga Departamenti i Financës.

[Referenca: An. 1_1 “Statuti i KUQ”; An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”; An. 2_6 “Stafi Akademik sipas Departamenteve të FE, 2021-2022”; Dokumenti shtesë nr. 4 “Tabelat për tre vitet e fundit të stafit të angazhuar pranë dep.”]

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në

Fakulteti i Ekonomisë/Departamenti i Financës nuk ka angazhuar personel ndihmës akademik apo administrativ.

<p>fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se praktika mësimore ndiqet nga një pedagog i departamentit si dhe nga mbikqyrësi në institucionin/subjektin ku zhvillohet praktika.</p> <p>GVJ konstatoi se pranë KUQ, sekretaria mësimore ishte personeli administrativ i vetëm në nivel institucioni dhe aktualisht mbulonte edhe pozicionin e specialistes në zyrën e burimeve njerëzore dhe të protokoll-arkivit. Për shkak të numrit të vogël të personelit administrativ dhe mungesës së personelit ndihmës akademik, GVJ konstatoi një mbivendosje të detyrave të tyre.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ sugjeron që personeli ndihmës akademik/administrativ duhet të jetë në nivel njësie kryesore, në mënyrë që edhe personeli akademik të ketë më shumë mundësi të fokusohet në punën e tij akademike dhe kërkimore-shkencore.</p> <p>Rregullorja e Departamentit të Financës përcakton që kohëzgjatja e praktikës mësimore përcaktohet në kurrikulën e programit të studimit. GVJ konstaton se as rregullorja e programit të studimit dhe as kurrikulat nuk specifikojnë kohëzgjatjen e praktikës profesionale të këtij program studimi në javë, por vetëm në orë dhe kredite të praktikës.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 2_6 "Stafi Akademik sipas Departamenteve të FE, 2021-2022"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në kërkesat e nenit nr.7 të Rregullores së programit të studimit, me vendim të Dekanit të FE është emëruar një Koordinator për të gjitha programet e studimit, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjitha programeve të studimit që ofrohen nga Fakulteti i Ekonomisë, pavarësisht se sipas parashikimeve të kuadrit ligjor çdo program studimi duhet të ketë një koordinator. Koordinatori ka për detyrë të mbajë kontakte të vazhdueshme dhe të ndihmojë pedagogët për zhvillimin e procesit mësimor si dhe të asistojë studentët gjatë zhvillimit të provimeve, praktikave dhe mbrojtjes së mikrotezës.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 2_9_1 "Vendim për emërimin dhe detyrat e koordinatorit të programit MSHFIN"]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës i përmbushin standardet ligjore lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive. - Numri i personelit akademik efektiv është numri minimal që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.



	<p>- Pjesa më e madhe e personelit akademik efektiv të angazhuar pranë këtij programi studimi nuk i përket departamentit të Financës.</p> <p>- Ka pasaktësi në raportimin e personelit akademik me kontratë të Departamentit të Financës për vitin akademik 2021-2022 dhe të personelit akademik efektiv që u takon departamenteve të tjera.</p> <p>- Nuk ka personel ndihmës akademik në nivel njësie kryesore/bazë, por vetëm një sekretare në nivel institucioni, e cila kyen edhe detyrën e asistentes në zyrën e burimeve njerëzore dhe të protokoll arkivës.</p> <p>- Koordinator i caktuar është përgjegjës për të gjitha programet e studimit që ofron Fakulteti i Ekonomisë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës kanë hartuar rregulloret përkatëse dhe kanë përgatitur të gjithë dokumentacionin për zhvillimin e programit të studimit duke përfshirë planin mësimor, programet e lëndëve, informacionin mbi stafin akademik të angazhuar në programin e studimit etj.</p> <p><i>[Referenca: An. 2_3 "Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 "Rregullore e Departamentit të Financës"; An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_9 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit të "Masterit të Shkencave në Financë" përmban informacion në lidhje me ngarkesën mësimore sipas semestrave, orët në auditor dhe jashtë auditorit, të ndara në orë leksioni dhe orë seminari.</p> <p>Programi i studimit zgjat dy vite akademike. Për çdo semester janë parashikuar 300 orë në auditor dhe 450 orë jashtë auditorit. Gjatë semestrit të katërt studenti kryen praktikën me 300 orë mësimore gjithsej dhe punon për temën e diplomës me 450 orë mësimore gjithsej.</p> <p>Në programin mësimor të lëndëve (sipas Aneksit 3_9_2 "Programi mësimor i lëndëve të MSHFIN 2021-2022") është përcaktuar klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr.41:</p>

- Kategoria A – Dy lëndë bazë me 12 ECTS zënë 10% të totalit të krediteve (brenda kufijve ligjorë 5% - 10% të krediteve);
- Kategoria B – Njëmbëdhjetë lëndë karakterizuese me 66 ECTS zënë 55% të totalit të krediteve (brenda kufijve 50% - 60% të krediteve);
- Kategoria C – Dy lëndë ndërdisiplinore me 12 ECTS zënë 10% të totalit të krediteve (brenda kufijve 12% - 20% të krediteve);
- Kategoria D – Një lëndë plotësuese (praktika profesionale) me 12 ECTS e cila zë 10% të totalit të krediteve (në përputhje me kufirin 10% të krediteve);
- Kategoria E – Tema e mikrotezës si detyrim përmbyllës me 18 ECTS e cila zë 15% të totalit të krediteve (brenda kufijve 10% - 15% të krediteve).

GVJ konstaton se në një dokument tjetër të emërtuar përsëri Aneksi 3_9_2 (Programi i lëndëve në “Master i Shkencave Financë” 2021-2022), i cili pasqyron në mënyrë më të detajuar ndarjen e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit dhe sipas semestrave, shpërndarja e krediteve midis lëndëve nuk është bërë sipas dokumentit të cituar më sipër (Aneksi 3_9_2 “Programi mësimor i lëndëve të MSHFIN 2021-2022”).

GVJ vlerëson se totali i krediteve për çdo kategori është në përputhje me kufijtë e vendosur nga VKM nr. 42, por shpërndarja e lëndëve në kategori nuk është bërë duke marrë parasysh përmbajtjen/tipologjinë e lëndëve. Për shembull, lëndë si Ekonometria dhe Ekonomiksi Menaxherial janë përfshirë në kategorinë “B” si lëndë karakterizuese. GVJ është e mendimit që këto janë lëndë plotësuese dhe ndërdisiplinore dhe duhet të përfshihen në kategorinë C. Për këtë arsye GVJ sugjeron që të rritet numri i lëndëve “karakterizuese” që janë në përputhje me profilin e programit të studimit “Financë” dhe të ulet numri i lëndëve të tjera ndërdisiplinore. Në këtë mënyrë programi i studimit do të ofrojë njohuri më të thelluara në disiplinën e financës.

Plani mësimor të cilit i është referuar GVJ i përket vitit akademik 2021-2022. Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua se në vitin akademik 2020-2021 u rishikuan të gjitha syllabuset e lëndëve për t’i përshatur me kërkesat e VKM nr. 879 dhe rekomandimet e Bordit të Akreditimit.

GVJ konstaton se ndryshimi në planin mësimor të lëndëve për sa i përket përmbajtjes së tyre është bërë në vitin akademik 2021-2022. Nga verifikimi me regjistrin e arritjeve akademike të studentëve, GVJ konstatoi se edhe viti akademik 2020-2021 ka punuar me planin mësimor të vjetër.

Gjithashtu, ndryshimi midis planit mësimor të vitit 2021-2022 në krahasim me vitet akademike 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021 është më shumë se 20%. Nuk ka vetëm ndryshim kreditesh sikurse përcaktohet

	<p>në vendimin e Senatit nr. 17/1, date 09.12.2019, por ka edhe ndryshim të lëndëve që përmban plani mësimor.</p> <p>Si përfundim, GVJ konstaton se ndryshimi nuk është bërë që në vitin akademik 2020-2021 sikurse raportohet në RVB, dhe ndryshimi nuk është vetëm 20% sikurse përcaktohet në vendimin e senatit i cili i është përcjellë Ministrisë së Arsimit me shkresë datë 13.05.2020 dhe nr. prot. 2238/2.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9_2 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_9_2 "Programi Mësimor i lëndëve MSHFIN, 2021-2022"; An. 3_19 "Vendimi i Senatit për ndryshimin e planit mësimor të MSHFIN"; An. 3_1 "Dosja e programit të studimit Msc_Financë"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit, që është hartuar në bazë të Rregullores së KUQ dhe Rregullores së FE, përcakton kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit. Sipas nenit 9 të rregullores së programit të studimit, në këtë program studimi pranohen të gjithë studentët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret shtesë të Kolegjit, për programe për të cilat kërkohen kritere shtesë. Në faqen zyrtare të internetit të institucionit, në dokumentin mbi programin e studimit "Master i Shkencave në Financë" specifikohet që pranohen "Kandidatë që zotërojnë një diplomë "Bachelor" në këtë fushë dhe fushën e ekonomisë e fusha të tjera të ngjashme".</p> <p>Rregulloret e njësisë kryesore (Kreu X) dhe bazë (Kreu VIII) përcaktojnë kriteret dhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Për këtë qëllim, pranë Fakultetit të Ekonomisë me vendim të dekanit ngrihet Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve. Rregullorja e programit të studimit (neni 9) njeh vetëm njohjen e krediteve të studentëve që kanë përfunduar programin e ciklit të dytë "Master Profesional" të KUQ dhe nuk përcakton nëse lejohet transferimi i studentëve nga programe të ofruara nga IAL të tjera.</p> <p>Në këtë program studimi janë transferuar dy studentë gjatë vitit akademik 2020-2021 dhe tre studentë gjatë vitit akademik 2021-2022.</p> <p>GVJ sugjeron që kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi të jenë më specifike, jo të përgjithshme (vetëm zotërimi i një diplome Bachelor) sikurse përcaktohet në rregullore. Aftësitë dhe kompetencat që synon t'u japë studentëve ky program studimi, sikurse në çdo program studimi master të shkencave të nivelit të dytë, kërkojnë zotërimin e njohurive bazë në disiplinat përkatëse.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit duhet të përcaktojë qartë kriteret e transferimit të studentëve, në përputhje me rregulloret e njësisë kryesore dhe bazë.</p>

	[Referenca: An. 2_3 "Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 Rregullore e Departamentit të Financës"; An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"]			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Dokumentacioni lidhur me programin e studimit përmban programet lëndore (syllabuset) për çdo lëndë që përmban plani mësimor. Programet e lëndëve janë të unifikuar dhe të hartuar sipas formatit të kërkuar nga VKM nr. 41, ndryshuar me VKM nr. 879. Ato përmbajnë të gjithë elementët që kërkohen nga aktet rregullatore si emrin dhe adresën elektronike të pedagogut që zhvillon lëndën, kreditet, semestrin ku zhvillohet lënda, ngarkesën e orëve të leksioneve dhe seminareve, temat për çdo javë mësimi me literaturën përkatëse si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti dhe mënyrën e vlerësimit të tij. [Referenca: An. 3_9_2 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se programet e lëndëve diskutohen në fillim të çdo viti akademik gjatë analizës vjetore që bëhet në departament. Në bazë të RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ nuk ka evidencë që dosja e programit arkivohet në anglisht.			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani mësimor i programit të studimit është strukturuar dhe organizuar kryesisht sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. - Ndryshimi i planit mësimor është bërë në vitin akademik 2021-2022 dhe jo në vitin 2020-2021 sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion. - Plani mësimor ka ndryshuar jo vetëm në shpërndarjen e krediteve por edhe në përmbajtjen e tij – emërtimi i lëndëve. - Klasifikimi i lëndëve sipas kategorive të VKM nr. 41 nuk është bërë sipas tipologjisë së lëndës. - Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit janë shumë të përgjithshme duke lejuar që në këtë program studimi të regjistrohen studentë që kanë një diplomë "Bachelor" nga çfarëdo programi studimi. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” është një program i ciklit të dytë të studimeve, në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë “Master i shkencave” në “Financë”. Programi i studimit përmban lëndë specifike të fushës së financës, por edhe lëndë që synojnë t’i japin studentit një formim të përgjithshëm edhe në fushën e ekonomiksit, menaxhimit dhe marketingut. Në këtë mënyrë, studentët kanë mundësi të hyjnë në tregun e punës, të kryejnë kualifikime pasuniversitare dhe studentët me rezultate të larta kanë mundësi të ndjekin studime të thelluara pasuniversitare për doktoraturë.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9_2 “Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An. 3_10 “Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022”; An. 3_4 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”]</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Bazuar në Planin mësimor të programit, shpërndarja e lëndëve është bërë në mënyrë uniforme gjatë tre semestrave të parë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ pesë lëndë për çdo semester; ▪ 150 orë mësimore leksione në auditor për çdo semestër; ▪ 150 orë mësimore seminari në auditor për çdo semestër; si dhe ▪ 30 kredite për çdo semestër. <p>Gjatë semestrit të katërt zhvillohet edhe praktika profesionale me 12 kredite dhe në përfundim mbrohet punimi i diplomës me 18 kredite. Shpërndarja e lëndëve në semestra, e krediteve dhe orëve mësimore në auditor është e balancuar dhe bën të mundur arritjen e objektivave të programit të studimit dhe sigurimin e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor nuk kuptohet qartë shpërndarja e ngarkesës mësimore (orët në auditor dhe orët jashtë auditorit) në varësi të krediteve të lëndëve – ngarkesa varion nga 24, 25 në 26 orë mësimore për kredit. GVJ rekomandon që të përcaktohet në rregullore sa orë mësimore përmban një kredit.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9 “Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”]</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e</p>	<p>Bazuar në planin mësimor dhe programet e lëndëve dhe nga takimet me pedagogë dhe studentë, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit dhe shpërndarja e orëve mësimore dhe krediteve në dy vite është e balancuar, e përafërt edhe me programe të tjera të ngjashme</p>

<p>përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>ndërkombëtare dhe të hapësira për kombinimin e duhur teoriko-praktik. Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse të programit të studimit u shprehën se për hartimin e planit mësimor ishin bazuar më shumë në programe studimi të ngjashme të ofruar brenda vendit.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se numri i lëndëve që i takojnë disiplinës së financës është pothuaj i njëjtë me numrin e lëndëve të disiplinave të tjera të fushës ekonomike. Në mënyrë që studentët të fitojnë kompetencat dhe aftësitë e duhura për të punuar në sektorë të ndryshëm të financës, që është edhe profili i këtij programi studimi, GVJ sugjeron që të rritet numri i lëndëve që i takojnë profilit të financës.</p> <p>[Referenca: An. 3_9 “Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An. 3_10 “Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022”]</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Sipas <i>Planit mësimor të programit të studimit lëndët janë klasifikuar si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Teori (leksione) – 450 orë në auditor dhe 755 orë mësimore jashtë auditorit ▪ Seminare – 450 orë në auditor dhe 595 orë jashtë auditorit ▪ Praktike – 120 orë në auditor dhe 180 orë jashtë auditorit ▪ Temë diplome - 180 orë në auditor dhe 270 orë jashtë auditorit <p>GVJ konstaton se ky program studimi ofron mundësi praktike në fushën e financës si ekspertë dhe drejtues financiarë në biznese private, ekspertë fiskalë në biznese dhe institucione publike, ekspertë bankarë etj.</p> <p>GVJ konstaton një raport jo të drejtë midis lëndëve të kategorisë karakterizuese dhe lëndëve të kategorisë bazë sikurse është shprehur edhe në kriterin 2 të Standardit II.3. Disa lëndë që në planin mësimor paraqiten si karakterizuese nuk janë lëndë që lidhen drejtpërdrejt me fushën e studimit të këtij programi studimi. Edhe lëndët me zgjedhje janë lëndë që i përkasin më shumë fushës së menaxhimit se të financës. Si një program studimi i ciklit të dytë, GVJ mendon se duhet të japë më shumë njohuri të thelluara në fushën e financës që është edhe profili i këtij programi studimi, në mënyrë që edhe mobiliteti apo transferimi i studentëve nga dhe për në programe të tjera të jetë lehtësisht i mundshëm.</p> <p>[Referenca: An. 3_9 “Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”]</p>

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se programet e lëndëve rishikohen çdo vit akademik dhe literatura e detyrueshme dhe ndihmëse përditësohet me literaturën bashkëkohore në shqip dhe gjuhë të huaj.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"; Vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit nuk përcakton qartë se cilat janë objektivat e programit të studimit, aftësitë dhe kompetencat e synuara për këtë program studimi.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se në përgjithësi përmbajtja e programeve të lëndëve lejon fitimin e dijeve, kompetencave dhe aftësive të synuara në lëndë. Megjithatë GVJ konstaton se përmbajtja e programeve të disa lëndëve duhet të përshtatet më shumë me emërtimin e tyre. Gjatë takimit me stafin akademik, pedagogët konfirmuan se tema lidhur me menaxhimin e institucioneve financiare jo-bankare apo sigurimet që mungojnë në syllabuset e lëndëve i trajtojnë nëpërmjet detyrave të kursit dhe rasteve studimore.</p> <p>GVJ sugjeron që të ndryshojë emërtimi i lëndës në përputhje me përmbajtjen e syllabusit ose anasjelltas.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"; Vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Si një program i ciklit të dytë të studimeve, ky program synon të përgatisë studentë të aftë për të hyrë dhe për t'iu përshtatur tregut të punës si dhe mundëson për studentët me rezultate të larta vazhdimin e kualifikimeve dhe studimeve të thelluara pasuniversitare.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"; An. 3_9_2 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, megjithëse në rregulloren e programit të studimit objektivat janë shumë të përgjithshëm. - Shpërndarja e lëndëve dhe orëve në auditor është bërë e balancuar mes semestrave. - Programi i studimit përmban shumë lëndë nga disiplina ekonomike jo-financiare. - Ngarkesa mësimore për një kredit është e ndryshme për lëndë të ndryshme.

	- Emërtimi i disa lëndëve nuk përputhet me përmbajtjen e tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, në vitin 2021 KUQ ka realizuar një studim mbi kërkesat e tregut për specialistë në fushën e financës. GVJ konstaton se ky studim përmban të dhëna të vjetra (deri në vitin 2018), nuk është i orientuar drejt fushës së financës dhe nuk përmban një analizë të mirëfilltë mbi llojet e profesioneve që kërkohen nga bizneset dhe institucionet e ndryshme publike dhe private.</p> <p>Dokumentacioni bashkëngjitur RVB përmban edhe një studim tregu mbi programin “Bachelor në Menaxhim Biznesi” ku një pjesë e mirë e përfundimeve janë të njëta (si p.sh mbi mundësitë e punësimit në përfundim të programeve të studimit).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se institucioni shfrytëzon marrëveshjet e bashkëpunimit për të mbajtur kontakte me tregun e punës dhe për të reflektuar nevojat e tyre me njohuri dhe kompetenca që duhen përçar tek studentët.</p> <p>Sipas RVB, institucioni ka ngritur edhe Bordin Këshillimor të Biznesit, por në dokumentacion nuk ka asnjë evidencë mbi ngritjen dhe veprimtarinë e këtij bordi.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_13 “Studim i tregut të punës MSHFIN, 2021-2022”;</i> <i>An. 3_13 “Studim i tregut të punës MSH_R_H_AP”]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e studentëve bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në disa organe drejtuese dhe këshillimore të KUQ si Senati Akademik, NJSBC, Këshilli i Etikës, komisionet e përhershme etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua fakti se gjatë mbledhjeve të këtyre organeve dhe të departamentit në rastet kur ftohen studentë, ata japin mendimin e tyre lidhur me përmirësimin e programit të studimit, megjithëse nuk ka evidencë për pjesëmarrjen e tyre.</p>

	[Referenca: An_1_1 "Statuti i KUQ"; An_1_3 "Rregullore e Kolegjit Universitar Qirjazi"]			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua se gjatë aktiviteteve të ndryshme si tryeza të rrumbullakta, workshop-eve me biznese dhe institucione publike, Departamenti i Financës përmirëson dhe përditëson programin e "Masterit të Shkencave në Financë". [Referenca: Vizita në institucion]			
Konkluzione	GVJ konstaton se për përmirësimin e programit të studimit: - KUQ ka kryer një studim tregu, i cili nuk ka një analizë të mirëfilltë sasiore dhe nuk lidhet plotësisht me këtë program studimi dhe tregun e punësimit që synon ky program. - Njësia përgjegjëse angazhohet për të reflektuar mendimet e studentëve dhe propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme nëpërmjet konsultimit me aktorë të biznesit dhe institucione të ndryshme, por mungojnë evidencat formale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Rregullorja e programit të studimit përmban qëllimin dhe parimet mbi të cilat mbështetet ky program studimi të cilat janë në përputhje me objektivat kryesorë të institucionit të paraqitura në statut dhe në planin e tij strategjik. Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit, si në rregulloren e programit të studimit edhe në planin strategjik të programit të studimit nuk janë shprehur qartë prioritetet dhe mungojnë objektivat kryesorë specifike për këtë program studimi. [Referenca: Referenca: An_1_1 "Statuti i KUQ"; An_1_2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të kolegjit Universitar Qirjazi"; An_1_3 "Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit MSHFIN"; An_3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e	GVJ konstaton se Departamenti i Financës mbështet personelin akademik në procesin e mësimdhënies dhe në aktivitetin e tij kërkimor dhe shkencor duke respektuar lirinë e tij akademike.

<p>mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Liria akademike përcaktohet si një parim mbi të cilin mbështetet aktiviteti i personelit akademik pothuaj në të gjitha aktet dhe rregulloret e institucionit si Statuti, rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, rregullore e programit të studimit etj.</p> <p><i>[Referenca: Referenca: An. 1_1 "Statuti i KUQ"; An. 1_2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të kolegjit Universitar Qirjazi"; An. 2_3 "Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në studime dhe projekte kërkimore bëhet nëpërmjet përfshirjes së tyre në përgatitjen e temës së diplomës dhe të detyrave të kursit, si dhe kryerjes së praktikës profesionale. Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB dhe nga vizita në institucion nuk rezultojnë që studentët e këtij programi studimi të jenë angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete të tjera shkencore.</p>			
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Për mbështetjen e kërkimit shkencor, institucioni ka zhvilluar gjatë tre viteve të fundit dy simpoziume dhe disa workshope, tryeza të rumbullakta dhe leksione të hapura, shumë pak prej të cilave lidhen me fushën e programit të studimit. Bordi i Administrimit ka marrë vendim që institucioni të financojë të gjitha aktivitetet kërkimore dhe shkencore që organizohen nga ai si dhe ka vendosur një fond të veçantë për kërkimin shkencor të pedagogëve dhe studentëve. Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB, për vitin 2021-2022, Senati Akademik ka miratuar një fond prej 24'000 euro të vënë në dispozicion të kërkimit shkencor, nga të cilat 8'000 euro i janë akorduar Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>[Referenca: Referenca: An. 1_16_1 "Miratimi i fondit për punën shkencore, viti akademik 2011-2022"]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e programit të studimit nuk përcakton qartë objektivat dhe prioritetet specifike të programit të studimit. - KUQ respekton lirinë akademike të personelit akademik. - Studentët e programit të studimit nuk janë të angazhuar në projekte dhe aktivitete kërkimore të institucionit. - KUQ angazhohet për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor, i cili duhet të orientohet më shumë drejt fushës së programit të studimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Zhvillimi i standardeve sa më të larta për punë kërkimore shkencore përbën një nga shtyllat ku mbështetet misioni i KUQ, i cili ka për qëllim integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, publike dhe private, me njësi biznesi dhe shoqata të ndryshme në mënyrë që të zhvillojë punën kërkimore të personelit akademik dhe studentëve. Ngritja e Qendrës së kërkimit shkencor si njësi e veçantë në nivel Fakulteti ka për qëllim arritjen e objektivave lidhur me kërkimin shkencor.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_2 “Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar Qirjazi”; An. 1_18 “Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KUQ”; An. 1_19 “Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ”]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik konfirmoi mbështetjen e institucionit dhe Fakultetit Ekonomik për të nxitur dhe inkurajuar stafin akademik në pjesëmarrje në projekte dhe analiza me karakter kërkimor shkencor.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB, rezultojnë disa pedagogë që kanë marrë pjesë në projekte Erasmus +, të Ministrisë së Arsimit, Kryqit të Kuq etj. GVJ konstaton se numri i këtyre projekteve është i kufizuar dhe studentët nuk janë të përfshirë.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_18 “Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KUQ”; An. 1_19 “Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ”]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Referuar dokumentacionit vënë në dispozicion, gjatë tre viteve të fundit KUQ ka organizuar dy simpoziume në bashkëpunim me IAL të tjera, leksione të hapura dhe stafi akademik ka marrë pjesë në seminare, konferenca, tryeza të rumbullakta etj. GVJ konstaton se numri i aktiviteteve shkencore në fushën e ekonomisë është i vogël dhe pothuaj mungon organizimi i aktiviteteve shkencore që lidhen drejtpërdrejt me fushën e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_18 “Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KUQ”; An. 1_19 “Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ”]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë</p>	<p>Qëllimi i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” synon përgatitjen e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e financës si</p>

konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>menaxherë financiarë në njësitë e biznesit dhe në intitucione financiare, specialistë fiskalitetesh, kontabilistë, menaxherë risku etj., të aftë për të hyrë dhe përshtatur tregut të punës. KUQ është liçensuar edhe për ofrimin e kurseve profesionale për Kontabilitet dhe Financë.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9_2 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_20 "Liçensa e KUQ për kurse kualifikimi në Financë"]</i></p>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p>Sipas RVB, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ i'u konfirmua angazhimi i institucionit për të marrë në konsideratë sugjerimet dhe rekomandimet e nxjerra nga shoqatat dhe rrjetet profesionale dhe përfshirja e tyre në programin mësimor dhe zhvillimin e aktivitetit mësimdhënës dhe kërkimor shkencor.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9_2 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; Vizita në institucion]</i></p>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	<p>Nuk është program studimi për profesione të rregulluara.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se institucioni angazhohet në mbështetjen e kërkimit shkencor nëpërmjet organizimit të simpoziumeve dhe leksioneve të hapura, por kërkimi shkencor duhet të jetë më i orientuar drejt programit të studimit dhe duhet të përfshijë edhe studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit të “Masterit të Shkencave në Financë” përcakton si forma të mësimdhënies dhe transferimit të dijeve leksionet, seminarët, detyrat e kursit, punime individuale të studentëve dhe praktikat profesionale. Këto forma mësimdhënieje janë specifikuar edhe në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve dhe nga takimi me stafin akademik GVJ konstaton se përdoren gjatë procesit mësimor. Plani mësimor i programit të studimit parashikon format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Leksione - 450 orë mësimore në auditor dhe 755 orë mësimore jashtë auditorit. ▪ Seminare - 450 orë mësimore në auditor dhe 595 orë mësimore jashtë auditorit. ▪ Praktikë profesionale – 120 orë mësimore në auditor dhe 180 orë mësimore jashtë auditorit. ▪ Temë diplomë - 180 orë mësimore në auditor dhe 270 orë mësimore jashtë auditorit. <p>Në total parashikohen 3.000 orë mësimore – 1.200 orë në auditor dhe 1.800 orë punë e pavarur.</p> <p>Për çdo lëndë janë parashikuar 60 orë në auditor leksione dhe seminarë. Nga shqyrtimi i orarit mësimor të publikuar për vitin akademik 2021-2022, i cili është vënë në dispozicion në bazë të kërkesës së GVJ gjatë vizitës në institucion, rezulton se për çdo lëndë orari parashikonte 12 orë në javë që realizoheshin në katër javë – pra gjithsej 48 orë në auditor.</p> <p>Plani mësimor dhe syllabuset nuk parashikojnë orë laborator, pavarësisht se gjatë vizitës në institucion GVJ i’u pohua se laborator i ekonomisë dhe informatikës përdorej nga studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9_2 “Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An. 3_10 “Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022”; Dokumenti nr. 22: Orari mësimor i dy viteve të fundit e kalendari i provimeve”]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë takimit me personelin akademik, GVJ konstaton se pedagogët angazhohen në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike. Në bazë të feedback-ut të marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studimi</p>

	<p>në grup për të nxitur bashkëpunimin mes palëve në kushte simuluese të punës etj. Institucioni ka përdorur edhe platforma on-line të mësimdhënies si Moodle dhe gjatë dy viteve të fundit Google Classroom dhe Zoom.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 1_23 "Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimit on-line"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni angazhohet në kualifikimin dhe mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodave pedagogjike. Për këtë qëllim janë organizuar leksione të hapura, workshop-e si dhe janë hartuar udhëzues për kualifikimin e personelit akademik (orientues për kriteret e nevojshme të kualifikimit) dhe udhëzues mbi përdorimin e platformave on-line të mësimdhënies.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_23 "Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimit on-line"; An. 1_13 "Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik të KUQ"]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit "Master i Shkencave në Financë" ka ekspertizën e duhur për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të prezantuara në syllabuset e lëndëve përkatëse. Bazuar në CV-të e personelit akademik, të gjithë pedagogët kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e ekonomisë. Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik theksoi se në leksione/seminare përdorin metoda të ndryshme interaktive të mësimdhënies për të nxitur mendimin kritik dhe krijues të studentëve, punën në grup nëpërmjet detyrave në grup si dhe punën e pavarur nëpërmjet zhvillimit të eseve/detyrave individuale që parashikohen në programet e lëndëve.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_8 "CV-të e stafit akademik që japin mësim në programin e studimit MSHFIN 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas RVB dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se çdo fillim viti akademik, Departamenti i Financës rishikon programet e lëndëve, pjesë e së cilave janë edhe format dhe metodat e mësimdhënies. Në këtë proces reflektohen rezultatet e analizës së pyetësorëve të studentëve, në fund të çdo semestri, të cilat diskutohen në mënyrë periodike me të gjitha strukturat mësimdhënëse dhe drejtuese të KUQ, me qëllim përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në institucion. Institucioni angazhohet dhe organizon</p>

	<p>leksione të hapura dhe trajnime për kualifikimin e mëtjshëm në këtë drejtim të personelit akademik.</p> <p>[Referenca: An. 3_8 "CV-të e stafit akademik që japin mësim në programin e studimit MSHFIN 2021-2022"; An. 1_13 "Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik të KUQ"; An. 1_19 "Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ"]</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>KUQ ka hartuar një udhëzues mbi kualifikimin shkencor të personelit akademik dhe ndihmës akademik (orientues për kriteret e nevojshme të kualifikimit), nëpërmjet të cilit udhëzohet që të organizohen takime dhe tryeza të rrumbullakta midis pedagogëve të rinj dhe atyre me eksperiencë, të realizohen seminare midis personelit akademik për përdorimin dhe përmirësimin e metodave interaktive, veçanërisht mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit në funksion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, si dhe leksione të hapura mbi modelet e mësimdhënies dhe të nxënit, motivimin e punonjësve në punë, planifikimin në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim.</p> <p>[Referenca: An. 1_13 "Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik të KUQ"; An. 1_19 "Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ"]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Orët në auditor nuk janë realizuar sipas planifikimit në planin mësimor. - Personeli akademik i programit të studimit është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. - KUQ angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në</p>	<p>Rregullorja e Departamentit (nenet 27, 28) dhe Rregullorja e programit të studimit (neni 15), të hartuara në bazë të rregullores së KUQ dhe të Fakultetit të Ekonomisë përcaktojnë kriteret e frekuentimit dhe mënyrën e vlerësimit të studentit.</p>

<p>Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Sipas rregulloreve vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit bëhet nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 25-40 pikë studentët marrin nëpërmjet pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve në leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi, detyra kontrolli; si dhe ▪ 75-60 pikë studentët e marrin nëpërmjet provimit përfundimtar. <p>Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve, GVJ konstaton se të gjitha programet e bëjnë vlerësimin e studentit në përputhje me përcaktimet e rregulloreve përkatëse.</p> <p>GVJ rekomandon që rregulloret të publikohen në faqen zyrtare të institucionit në mënyrë që të interesuarit dhe veçanërisht studentët të marrin informacionin e nevojshëm.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës; An. 3_4 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An. 3_10 “Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022”]</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në informacionet e marra gjatë viztës në Institucion dhe kryesisht nga diskutimet me studentët e programit të studimit, GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo semestri me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Ky prezantim bëhet nga pedagogët zakonisht në orën e parë të çdo lënde. Gjithashtu këtë informacion studentët kanë mundësi ta marrin edhe nga koordinatori i programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në Institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar rregulloreve të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, syllabuseve të lëndëve të ofruara në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë”, vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit duke kombinuar testime të ndërmjetme, detyra kursi, projekte, etj.</p> <p>Edhe gjatë takimit me pedagogë dhe studentë të programit të studimit, GVJ konstatoi përdorimin e një larmie të formave të vlerësimit që u jep mundësi të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të afësive dhe talenteve të tyre dhe të fitojnë kompetencat dhe njohuritë e duhura në përputhje me objektivat/qëllimet e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë;</i></p>

	An.3_3 "Rregullore e Departamentit të Financës; An.3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An.3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]			
Konkluzione	GVJ konstaton se - KUQ dhe njësitë përgjegjëse të programit të studimit kanë përcaktuar procedurat e vlerësimit dhe testimit të njohurive të studentëve në rregulloret përkatëse. - Vlerësimi dhe testimi i studentëve bëhet në përputhje me përcaktimet e paraqitura në rregullore dhe syllabuset e lëndëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Syllabuset e lëndëve të programit të studimit "Master i Shkencave në Financë" parashikojnë mënyrën e vlerësimit të studentëve gjatë gjithë vitit në mënyrë të unifikuar si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ 10% të pikëve maksimale studentët e marrin me pjesëmarrjen dhe diskutimin e angazhimin në seminare; ▪ 10% të pikëve maksimale nëpërmjet punimit të detyrave të seminarit dhe projekteve/detyrave të kursit ▪ 20% të pikëve maksimale nëpërmjet kolegiumit; si dhe ▪ 60% të pikëve maksimale nëpërmjet provimit përfundimtar. Ky vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit është konfirmuar edhe gjatë bashkëbisedimit të GVJ me studentët e këtij program studimi. [Referenca: An.3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sipas RVB për shkak të numrit të vogël të studentëve, institucioni nuk ka vënë në zbatim sistem elektronik të testimit dhe vlerësimit, pavarësisht se këto sisteme sugjerohen të përdoren për të rritur transparencën në vlerësim dhe për të shmangur mundësinë e abuzimit apo trajtimit diferencial të studentëve.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Gjatë takimit me pedagogë dhe studentë të programit të studimit, GVJ iu konfirmua se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në mënyrë të unifikuar, sipas rregullores dhe syllabuseve të përgatitura për çdo lëndë:


	<p>40% e vlerësimit bëhet nga detyrat dhe angazhimi i studentit gjatë vitit dhe 60% nga provimi përfundimtar.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_4 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022”; An. 3_10 “Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022”]</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Numri i studentëve në këtë program studimi është i vogël (për vitin akademik 2021-2022, janë regjistruar 7 studentë vitin e parë dhe janë transferuar dy studentë vitin e dytë – numri total i studentëve në vitin e dytë është 8). Ky numër i vogël i studentëve i jep mundësi personelit akademik që të vlerësojë dhe të ketë kontakte të drejtpërdrejta me studentët për t’i sqaruar ata mbi mënyrën e vlerësimit dhe për t’i këshilluar lidhur me procesin e të nxënimit dhe ndihmuar për t’u përmirësuar në të ardhmen.</p> <p><i>[Referenca: An. 2_14_1 “Studentë të rregjistruar në vite në FE”]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Neni nr. 34 i rregullores së Departamentit të Financës dhe neni 102 i Rregullores së Fakultetit Ekonomik ndalojnë kopjimin gjatë provimit me të gjitha mjetet dhe format, duke parashikuar edhe masat disiplinore që merren ndaj studentit në një rast të tillë, por rregulloret nuk shprehen për marrjen e masave ndaj plagjiaturës. Institucioni nuk disponon ndonjë program plagjiature, por për shkak të numrit të vogël të studentëve, pedagogët kanë mundësi të verifikojnë me mënyrat dhe mjetet e tyre plagjiaturën e detyrave të kursit dhe temave të diplomës.</p> <p><i>[Referenca: An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”]</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Procedura që ndiqet për komunikimin e vlerësimit të studentëve është e përcaktuar në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë (neni 64) dhe në Rregulloren e Departamentit të Financës (neni 33). Në përfundim të zhvillimit të lëndës, pedagogu u komunikoi studentëve pikët që kanë marrë nga vlerësimi i vazhdueshëm dhe nëse kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar. Provimet përfundimtare bëhen me shkrim, sekretohen nga sekretaria mësimore dhe maksimumi pesë ditë nga data e zhvillimit të provimit publikohen rezultatet paraprake. Kjo procedurë u konfirmua GVJ edhe nga takimi me personelin akademik, edhe nga takimi me studentët e këtij program studimi.</p> <p><i>[Referenca: An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”]</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e KUQ, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e Departamentit të Financës, në nenet përkatëse (përkatësisht nenet 65, 67 dhe 35) parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve ose vlerësimin në provim, kundrejt një kërkesë me shkrim.</p> <p>Nga shqyrtimi i këtyre neveve, GVJ konstatoi disa mospërputhje. Sipas Rregulloreve të KUQ ankesa i drejtohet Dekanit, ndërsa sipas Rregulloreve të njësisë përgjegjëse/bazë ankesa i drejtohet Përgjegjëses së Departamentit dhe për dijeni Dekanit të FE. Gjithashtu në këto dy të fundit nuk ka përcaktime kohore (afate) për kryerjen e ankesës.</p> <p>Në Rregulloren e KUQ, përcaktohet që ankesa për procesin duhet të bëhet menjëherë pas provimit, ndërsa ankesa për vlerësimin duhet të paraqitet brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit për rezultatin në provim nga sekretaria mësimore. Pas sqarimeve të nevojshme me përgjegjësen e departamentit, komisionin e provimit dhe studentin, në rast se ankesa është e drejtë, studentit i jepet e drejta të ripajë provimin me një komision të ri në një datë tjetër por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.</p> <p>GVJ sugjeron që Rregulloret e institucionit të jenë të harmonizuara dhe të specifikojnë më qartë procedurën dhe afatet e ankimimit.</p> <p>[Referenca: An_1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi ” (KUQ)..pdf; An_2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An_3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”]</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aktet rregullatore të KUQ përcaktojnë rregullat dhe mënyrat e vlerësimit të studentit dhe procedurat e ankimimit të tyre, por këto procedura duhet të jenë të harmonizuara. - KUQ nuk përdor sistem elektronik të vlerësimit të studentëve. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Plani strategjik i programit të studimit (pika II) dhe rregullorja e programit të studimit përcakton si mision të pogramit të studimit që:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që u ofrohen studentëve.

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përgatisë specialistë të lartë në fushën e Financës, për t'u përshtatur me nivelin e kërkesave të kohës dhe tregut të punës. ▪ Të përshtaten dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal. ▪ Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë, të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e brezit të ri për një shoqëri të tillë. <p>GVJ mendon se objektivat e programit të studimit janë shumë të përgjithshëm, duhet të jenë më specifike dhe të lidhen me fushën e përgjithshme të programit të studimit – financë. Përmbajtja e lëndëve të programit të studimit mundëson thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve, por sikurse GVJ është shprehur, programi përmban shumë lëndë të karakterit integruar. Për këtë arsye duhet të rritet numri i lëndëve të lidhura drejtpërdrejt me profilin e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit MSHFIN"; An. 3_4 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Plani mësimor i përogramit të studimit "Master i Shkencave në Financë" përmban lëndë që ofrohen edhe nga departamente të tjera, kryesisht nga departamenti i menaxhimit (si menaxhimi i sistemeve të informacionit, marketing ndërkombëtar, ekonomiks menaxherial, metodologji kërkimi, ekonometri), në mënyrë që studentët të pajisen me njohuri dhe aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, marketingut dhe komunikimit, si dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit "Master i shkencave në Financë", GVJ iu konfirmua angazhimi i pedagogëve për të ndihmuar studentët në asimilimin sa më mirë të programit të lëndës. Për këtë qëllim, në orën e fundit të mësimin, por edhe përpara zhvillimit të provimit studentët kanë mundësi të konsultohen me pedagogët e lëndës mbi çështjet kryesore, ku duhet të përqëndrohen për të përmbushur objektivat e lëndës dhe për të arritur rezultate sa më të mira në provim.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në Institucion]</i></p>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mbështetur në planin mësimor, GVJ konstaton se ky program studimi nuk parashikon shfrytëzimin e orëve në laborator, megjithatë nga programet e lëndëve (Sistemet e Informacioni & Kontabilitet i Avancuar) përdorin laboratorin e ekonomisë për të praktikuar programe specifike financiare si Financa 5. Laboratori i ekonomisë dhe laboratorin i informatikës janë vënë në dispozicion të studentëve për kryerjen e detyrave/projekteve të kursit apo edhe analiza dhe shkrimin e temës së diplomës si detyrim përmbyllës.</p> <p>Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", GVJ konstatoi se ata janë të hapur dhe mbështetës për dinamikën e punës në grup. Sipas tyre, kombinimi i studentëve në grupe pune për detyrat dhe projektet e kursit nxit diskutimet dhe mundëson zgjidhjen e problematikave. Praktika profesionale është një detyrim akademik që u jep mundësinë studentëve të zhvillojnë njohuritë teorike të marra në auditor.</p> <p><i>[Referenca: An. 3_9 "Plani Mësimor i lëndëve Master i Shkencave në Financë, 2021-2022"; An. 3_10 "Syllabuset e lëndëve të programit MSHFIN, 2021-2022"]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me personelin akademik, GVJ konstatoi angazhimin e tyre për të zhvilluar seminare dhe orë të hapura mbi zhvillimet e reja të shkencës, përdorimin e teknologjisë dhe metodat e mësimdhënies. Leksionet e hapura janë mbajtur si nga personeli akademik, edhe nga lektorë të ftuar vendas dhe të huaj.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_19 "Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ"]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Bazuar në Planin strategjik të KUQ, GVJ konstaton se institucioni është i angazhuar për të zhvilluar standarde më të larta për punën kërkimore dhe zhvillimin e tij në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Bordi i Administrimit ka marrë vendim për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve në konferencat e organizuara nga institucioni në bashkëpunim me IAL e tjera.</p> <p>Studentët janë organizuar në klube studentore, veprimtaria e të cilëve mbështetet dhe nxitet nga institucioni.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_16 "Vendimi i Bordit të Administrimit për pagesën e konferencave dhe pajisje e bibliotekës"; An. 1_16_1 "Miratim i fondit për punën shkencore viti akademik 2021-2022"]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>



	<p>- Përmbajtja e programit të studimit u siguron studentëve njohuri dhe aftësi në fusha të ndryshme të ekonomisë si financë, menaxhim, marketing dhe ekonomiks. Numri i këtyre lëndëve jo-financiare është pothuaj i njëjtë me numrin e lëndëve që i takojnë profilit të programit të studimit.</p> <p>- Personeli angazhohet që studentët të zhvillojnë aftësitë krijuese dhe të fitojnë kompetenca profesionale dhe shkencore nëpërmjet formave inovative të mësimdhënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit të “Master i Shkencave në Financë” parashikon si detyrim përmbyllës diplomimin nëpërmjet mbrojtjes së temës së diplomës.</p> <p>Procedura që duhet ndjekur gjatë punimit dhe mbrojtjes së diplomës përcaktohet në rregulloret përkatëse të institucionit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Informimi i studentëve mbi procedurat e diplomimit bëhet nga koordinatori i programit të studimit dhe Departamenti i Financës. GVJ rekomandon publikimin e rregulloreve në faqen zyrtare online të institucionit, që studentët (aktualë dhe potencialë) të informohen në çdo kohë mbi mënyrën dhe procedurat e diplomimit.</p> <p>[Referenca: An. 1_3 “Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi”; An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloret e njësisë përgjegjëse/bazë, studentët e programit “Master i Shkencave në Financë” në fillim të semestrit të dytë marrin listën me temat e diplomës që sugjerohen nga Departamenti i Financës. Personeli akademik asiston studentët në procesin e diplomimit përmes konsultimeve. Pedagogu udhëheqës i udhëzon për strukturën e projektit, metodologjinë, i orienton studentët drejt literaturës që ata duhet të lexojnë në funksion të temës, u jep udhëzime dhe të gjitha materialet e nevojshme për përfundimin me sukses të punimit të diplomës.</p> <p>Rregullorja e departamentit të Financës përcakton procedurat dhe afatet e diplomimit, ndërsa udhëzime mbi strukturën dhe punimin e diplomës jepen në një dokument të veçantë.</p>

	<p>GVJ konstaton se parashikimet në Rregulloren e Programit të Studimit si dhe Dokumenti me kërkesat për punimin e diplomës janë shumë të përgjithshme dhe nuk bëjnë dallimin e duhur mes cikleve dhe programeve të studimit, prandaj GVJ rekomandon rishikimin e tyre dhe hartimin e një udhëzimi në funksion të Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3 "Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi"; An. 2_3 "Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 2_10_Kërkesat për për përgatitjen e punimit të diplomës..pdf; An. 3_3 "Rregullore e Departamentit të Financës"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Kuadri rregullator i KUQ, përcakton organizimin dhe administrimin e provimit përfundimtar të diplomimit. Komisioni i vlerësimit të temës së diplomës përbëhet nga 5 anëtarë (sipas Rregullores së KUQ) dhe 3-5 anëtarë (sipas Rregullores së Departamentit) të cilët propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani.</p> <p>Për vlerësimin e temave të diplomave, komisionet e vlerësimit marrin në konsideratë punimin e paraqitur nga studenti, prezantimin gjatë mbrojtjes në komision, përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve të komisionit, vlerësimin e reçensës dhe të udhëheqësit etj.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3 "Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi"; An. 2_3 "Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 "Rregullore e Departamentit të Financës"]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e njësisë kryesore/bazë dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, Departamenti i Financës u jep studentëve listën e temave të diplomës në fillim të semestrit të dytë, nga e cila studenti mund të zgjedhë temën që dëshiron të punojë në bashkëpunim me udhëheqësin e temës së diplomës. Pedagogu udhëheqës e orienton dhe e ndihmon studentin jo vetëm në fillim për përcaktimin e temës së diplomës, por edhe gjatë punës lidhur me strukturën e punimit, metodologjinë dhe literaturën që duhet të studiojë, duke zhvilluar seanca orientuese.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3 "Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi"; An. 2_3 "Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 "Rregullore e Departamentit të Financës"]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ konstaton angazhimin e personelit akademik dhe vënien në dispozicion të të gjithë infrastrukturës fizike dhe logjistike për realizimin e punimit të diplomës. Biblioteka, laboratorët dhe ambiente të tjera të KUQ mund të shfrytëzohen nga studentët për kryerjen e hulumtimeve dhe analizave, përgatitjen e temës dhe prezantimit të</p>

	<p>diplomës. Edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione dhe njësi ekonomike, mundësojnë studentin që të sigurojë të dhëna dhe të realizojë analiza praktike lidhur me çështje të caktuara që trajtohen në punimin e diplomës.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3 “Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi”; An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”]</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Ditën e mbrojtjes së diplomës bëhet edhe vlerësimi i studentit nga komisioni i diplomimit. Pas mbrojtjes komisioni tërhiqet për të bërë vlerësimin përfundimtar. Secili anëtar i komisionit vlerëson me notë studentin dhe nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3 “Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi”; An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”]</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet sipas planit mësimor dhe ka mbrojtur punimin e diplomës pajiset me diplomë me titullin “Master i Shkencave në Financë”, të shoqëruar me listën e notave dhe me suplementin e diplomës, i miratuar nga Senati akademik dhe nga Ministria e Arsimit.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3 “Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi”; An. 2_3 “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An. 3_3 “Rregullore e Departamentit të Financës”]</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni në organikën e tij ka ngritur Zyrën e Burimeve Njërëzore dhe Protokoll-arkivit, në të cilin arkivohet i gjithë dokumentacioni lidhur me studentin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dokumentacioni i studentit mbahet nga sekretaria mësimore dhe arkivohet në zyrën e protokoll-arkivit sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Ky dokumentacion vihet në dispozicion të studentit me kërkesën e tij dhe të personave të autorizuar.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_6 “Rregullore e Zyrës së Burimeve Njërëzore dhe Protokoll-Arkivit”; An. 1_7 “Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale të KUQ”; An. 1_10 “Rregullore e Sekretarisë Mësimore”; An. 1_30 “Rregullore e për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit”]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p>- <i>Kuadri rregullator i institucionit përmban procedurat e kryerjes së detyrimeve përmbyllëse.</i></p>

	<p>- Këto procedura u komunikohen studentëve nëpërmjet personelit akademik dhe administrativ, por nuk bëhen publike në faqen zyrtare online të institucionit.</p> <p>- Udhëzuesi për temën e diplomës duhet të jetë i specifikuar për studimet e ciklit të dytë.</p> <p>- KUQ ruan dokumentacionin sipas legjislacionit në fuqi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi i studimit nuk është Master Profesional.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Programi i studimit nuk është Master Profesional.			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Programi i studimit nuk është Master Profesional.			
Konkluzione	Programi i studimit nuk është Master Profesional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbyshjes së standardeve të fushës III	Niveli i përmbyshjes	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbysh standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbysh kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ dhe dokumentacionin shtesë të kërkuar më pas, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar gjatë tre viteve të fundit akademike (2019-2022) në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Financë përmbysh kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik, për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve mësimore.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2021-2022, pranë këtij programi studimi janë angazhuar gjithsej 12 pedagogë nga të cilët 8 pedagogë janë personel akademik me kohë të plotë dhe 4 pedagogë janë personel akademik me kontratë (të jashtëm). Nga personeli akademik me kohë të plotë tre pedagogë mbajnë titullin Prof. Dr.; dy pedagogë mbajnë titullin Prof. As. Dr.; një pedagog mban gradën shkencore PhD dhe një pedagogë mban gradën shkencore Dr. Nga personeli akademik me kontratë një pedagog mban titullin Prof. Dr.; dy pedagogë mbajnë titullin Prof. As. Dr. dhe një pedagog mban gradën shkencore Dr.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vitit akademik 2020-2021, pranë këtij programi studimi janë angazhuar gjithsej 12 pedagogë, nga të cilët 8 pedagogë janë personel akademik me kohë të plotë dhe 4 pedagogë janë personel akademik me kontratë. Nga personeli akademik me kohë të plotë, tre pedagogë mbajnë titullin Prof. Dr.; një pedagog mban titullin Prof. As. Dr.; një pedagog mban gradën shkencore PhD dhe dy pedagogë mbajnë gradën shkencore Dr. Nga personeli akademik me kontratë, një pedagog mban titullin Prof. Dr.; dy pedagogë mbajnë titullin Prof. As. Dr. dhe një pedagog mban gradën shkencore Dr.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2019-2020, pranë këtij programi studimi janë angazhuar gjithsej 9 pedagogë, nga të cilët 6 pedagogë janë personel</p>

	<p>akademik me kohë të plotë dhe 3 pedagogë janë personel akademik me kontratë. Nga personeli akademik me kohë të plotë, dy pedagogë mbajnë titullin Prof. Dr.; dy pedagogë mbajnë titullin Prof. As. Dr. dhe dy pedagogë mbajnë gradën shkencore Dr. Nga personeli akademik me kontratë, një pedagog mban titullin Prof. Dr. dhe dy pedagogë mbajnë gradën shkencore PhD.</p> <p>GVJ konstaton se nga 8 pedagogët e angazhuar si personel akademik me kohë të plotë, pranë këtij programi studimi në dy vitet e fundit akademike (2020-2022), vetëm 3 pedagogë i takojnë Departamentit të Financës që është përgjegjës për këtë program studimi. GVJ gjykon se ky është tregues se numri i lëndëve që nuk përputhen me profilin e këtij programi studimi është i lartë, sikurse u shpjegua në fushën II, kriteri 2.3 të këtij raporti, apo se angazhimi i personelit akademik efektiv pranë departamentit përkatës nuk përputhet me natyrën dhe veçoritë e fushës mësimore-kërkimore.</p> <p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi informacion shtesë mbi ngarkesën mësimore gjithsej që mbulojnë pedagogët e këtij programi studimi pranë KUQ dhe mori konfirmimin që ngarkesa gjithsej është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_Shkencor_në_Financë_per_ASCAL.pdf; An_3_8_CV-të_e_stafit_akademik_që_japin_mësim_në_programin_e_studimit,_MSHFIN,_2021-2022..pdf; Doc_Shtesë_1.,_2._&_5.;_vizita_në_institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e KUQ, përkatësisht nenet 26-30 dhe neni 99, parashikohet respektimi i të drejtave lidhur me punësimin e personelit akademik që siguron Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë. GVJ konstatoi se informacioni i paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar lidhur me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi i referohej vetëm vitit akademik 2021-2022. Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në KUQ, GVJ vuri në dukje këtë mungesë dhe kërkoi plotësimin me informacion shtesë.</p> <p>Bazur në dokumentacionin shtesë, GVJ konstaton se në dy vitet e fundit akademike (2020-2022) pranë programit të studimit Master i Shkencave në Financë është angazhuar i njëjti personel akademik me kohë të plotë dhe me kontratë. Gjithashtu, GVJ konstaton se Departamenti i Financës, i FE të KUQ, ka në përbërje shtatë anëtarë të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët dy mbajnë titullin Prof. Dr., një mban gradën shkencore Dr. dhe katër anëtarë kanë kualifikimin Msc.</p> <p>Sic u përmend edhe në fushën II, nga kryqëzimi i informacioneve të mësipërme, GVJ konstatoi pasaktësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në raportimin e personelit akademik me kontratë të angazhuar pranë Departamentit të Financës për vitin akademik 2021-2022. Në Aneksin 2_6 raportohen 5 pedagogë me kontratë, ndërsa në

	<p>dokumentin shtesë Nr. 4 të vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ, raportohen 4 pedagogë me kontratë (ndryshim në numër por edhe në emra).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në raportimin e personelit akademik efektiv të angazhuar pranë programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” për vitin akademik 2021-2022. Nga tetë anëtarë të personelit akademik efektiv të raportuar dokumentin shtesë Nr. 3 të vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ, dy prej tyre nuk gjenden në listën e raportuar si personel akademik sipas departamenteve të FE për vitin akademik 2021-2022 në Aneksin 2_6. <p>Këto pasaktësi, zvogëlojnë transparencën e raportimit lidhur me qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe pranë institucionit. GVJ vlerëson se madhësia dhe përbërja e Departamenti të Financës është në kufijtë minimalë të parashikuar nga ligji Nr.80/2015 (neni 25, pika4), duke e ekspozuar institucionin ndaj rrezikut të mosplotësimit të kërkesave ligjore për funksionimin e departamentit në rast të largimit qoftë edhe të njërit prej anëtarëve të departamentit të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Duke qenë se kuadri rregullator i KUQ (neni 28 i Statutit) parashikon që të gjitha kategoritë e personelit akademik punësohen me kontratë me të drejtë përsëritje të kontratës, GVJ rekomandon rritjen e numrit të personelit akademik efektiv të angazhuar pranë Departamentit të Financës.</p> <p><i>[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ..pdf; An_1_3_Rregullore_e_Kolegjit_Universitar_„Qiriazi”_(KUQ)..pdf; An_2_6_Stafi_akademik_sipas_departamenteve_të_FE,_2021-2022..pdf; An_3_0_-Raporti_Vlerësimi_te_Brendshem_Master_Shkencor_në_Financë_per_ASCAL.pdf; Doc_Shtesë_1.,_2._&_5.; vizita_në_institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura e përzgjedhjes së personelit sipas kategorive përcaktohet në kuadrin rregullator të KUQ, Statutin (nenet 30-31) dhe Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njërëzore, Protokollit dhe Arkivës (ZBNJPA) (neni 4). Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe Statutin e KUQ.</p> <p>Në takimin me përfaqësuesin e ZBNJPA, GVJ u informua se kriteret e punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësia bazë, nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë dhe miratohen nga Rektori i KUQ. Proçesi i rekrutimit ndiqet nga kjo zyrë (ZBNJPA) në bashkëpunim me njësinë bazë përkatëse. Për vlerësimin e kandidatëve, me urdhër të Rektorit të KUQ ngrihet një komision <i>ad-hoc</i> me përfaqësues edhe nga njësia bazë e interesuar për punësimin. Vendimi për emërimin e</p>

	<p>kandidatit fitues, pas miratimit nga Rektori i KUQ, merret nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë Tregtare KUQ dhe kontrata e punësimit firmoset nga Administratori i KUQ.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh dhe me një dosje praktike rekrutimi të realizuar së fundmi nga institucioni dhe konstatoi se dosja ishte kryesisht e plotë lidhur me elementët e parashikuar.</p> <p><i>[Referenca: An_1_1_Statuti i KUQ.pdf; An_1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll-Arkivit.pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se angazhimi i personelit ndihmës në këtë institucion ishte në nivelet minimale për shkak edhe të numrit të kufizuar të studentëve. Aktualisht, pranë departamentit të Financës nuk ka të angazhuar personel ndihmës dhe mirëmbajtja e laboratorit të informatikës dhe mjediseve të tjera mësimore realizohej nga pedagogët.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>KUQ në organikën e tij ka ngritur Zyrën e Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivës (ZBNJPA) njësi në varësi të Administratorit të institucionit. Veprimtaria e zyrës bazohet në rregulloren përkatëse, Statutin e KUQ dhe kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>ZBNJPA është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë pranë të gjitha programeve të studimit të ofruara nga institucioni si dhe të personelit administrativ.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësuesin e kësaj zyre (dhe personelin e vetëm të punësuar pranë kësaj zyre), GVJ konstatoi se të dhënat mbaheshin në formatin e dosjeve fizike të strukturuar sipas elementëve të parashikuar në kuadrin rregullator përkatës.</p> <p>Informacioni lidhur me ngarkesën individuale të personelit akademik sipas lëndeve, semestrave dhe programeve të studimit mbahej pranë departamentit përgjegjës për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjet personale të dy pedagogëve të programit të studimit dhe konstatoi se dosjet ishin kryesisht të plotësuara me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomatat & çertifikatat, librezat shëndetësore etj (në një dosje mungonte kontrata e rinovuar).</p> <p><i>[Referenca: An_1_1_Statuti i KUQ.pdf; An_1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll-Arkivit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale KUQ ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucioni dhe njësie kryesore me përfaqësues</p>

<p>institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>të institucioneve publike dhe të bizneseve private, të cilat u mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Në detyrat e Koordinatorit të programit të studimit, funksion në nivel njësie kryesore, parashikohet edhe ndihma ndaj studentëve lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale dhe zgjedhjen e temave të diplomës. Gjatë realizimit të punimit të diplomës, studentët udhëhiqen nga pedagogu i miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Financës. Udhëheqësi mund të jetë pedagog me kohë të plotë ose me kontratë i programit të studimit dhe në fund të procesit përgatit një vlerësim mbi punimin e realizuar nga studenti sipas modelit të miratuar. Dekanati i FE ka përgatitur një udhëzues me kërkesa që duhet të mbahen parasysh nga studentët gjatë përgatitjes së temës së diplomës, për të gjitha programet e studimit.</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se në Rregulloren e Departamentit të Financës parashikohet se kohëzgjatja dhe afati i praktikës përcaktohet në programin mesimor të çdo fushe studimi. Nga programi mesimor i “Masterit Shkencor në Financë” rezulton se praktika profesionale parashikon 120 orë në auditor dhe 180 orë jashtë auditorit dhe zhvillohet në semestrin e katërt, me shkëputje nga procesi mesimor. Edhe për praktikën profesionale, për studentët është përgatitur një dosje udhëzuese, në nivel njësie kryesore dhe jo e dedikuar për këtë program studimi, me të gjithë informacionin për dokumentimin e procesit të praktikës, që nga kërkesa fillestare deri tek raporti mbi kryerjen e praktikës profesionale dhe vlerësimi i studentit.</p> <p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, ata konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për gjetjen e vendit të praktikës, megjithëse shumica e kishte gjetur vetë, pasi ishin të punësuar që gjatë viteve të studimit.</p> <p>GVJ rekomandon rishikimin e Rregullores së Programit të Studimit përsa i takon përfshirjes së kohëzgjatjes së praktikës profesionale dhe hartimin e udhëzuesve të dedikuar në nivel programi studimi lidhur me realizimin e e punimit të diplomës dhe të praktikës profesionale.</p> <p><i>[Referenca: An_1_8_Marëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brënda dhe jashtë vëndit.pdf; An_2_10_Kërkesat për përgatitjen e punimit të diplomës..pdf; An_2_9_1_Vendimi për emrimin dhe detyrat e Koordinatorit të programit MSHFIN.pdf; An_3_11_Model i dosjes së praktikës profesionale.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga 8 pedagogët e angazhuar si personel akademik me kohë të plotë, pranë këtij programi studimi në dy vitet e fundit akademike (2020-2022), vetëm 3 pedagogë i takojnë Departamentit të Financës që është përgjegjës për këtë program studimi. - Madhësia dhe përbërja e Departamenti të Financës, të FE të KUQ, është në kufijtë minimalë të parashikuar nga ligji Nr.80/2015, duke



	<p>e ekspozuar institucionin ndaj rrezikut të mosplotësimit të kërkesave ligjore për funksionimin e departamentit në rast të largimit qoftë edhe të njërit prej anëtarëve të departamentit të punësuar me kohë të plotë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pranë Departamentit të Financës nuk ka personel ndihmës apo ndihmës-akademik. Në përgjithësi pranë KUQ personeli ndihmës është në nivele minimale. - Zyra e Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivës ka vetëm një person në organikë dhe mbështetëj nga punonjësja e Sekretarisë Mësimore. - Koordinatorin e PS është në nivel njësie kryesore, një për të gjitha programet e studimit të FE. - Udhëzuesit me kërkesat (dosje model) për praktikën profesionale dhe realizimin e punimit të diplomës janë në nivel njësie kryesore dhe jo të dedikuar për këtë program studimi. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2															
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçmë sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.															
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve														
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” e zhvillon aktivitetin mësimor në ndërtesën kryesore të KUQ. Duke iu referuar numrit aktual të studentëve të institucionit, GVJ vlerëson se mjediset në këtë ndërtesë janë të mjaftueshme dhe të pajisuara me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor.</p>														
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të dhënat në vijim i referohen përmbledhtas mjediseve kryesore në dispozicion të të gjithë studentëve dhe personelit akademik pranë KUQ:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>MJEDISI</th> <th>NR. I SALLAVE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Salla seminari</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Laboratorë</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Zyra për personelin akademik</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë / Internet</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Ambiente ndihmëse (kancelari/zyra shërbimi/ të tjera ndihmëse)</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorin, bibliotekën dhe mjedise të tjera dhe vuri re që mjediset, sipas funksionit të tyre, ishin të pajisura edhe me kompjutera, projektorë dhe lidhje</p>	MJEDISI	NR. I SALLAVE	Salla leksioni	3	Salla seminari	7	Laboratorë	3	Zyra për personelin akademik	6	Bibliotekë / Internet	2	Ambiente ndihmëse (kancelari/zyra shërbimi/ të tjera ndihmëse)	6
MJEDISI	NR. I SALLAVE														
Salla leksioni	3														
Salla seminari	7														
Laboratorë	3														
Zyra për personelin akademik	6														
Bibliotekë / Internet	2														
Ambiente ndihmëse (kancelari/zyra shërbimi/ të tjera ndihmëse)	6														

	<p>interneti, si dhe kishin ndriçim dhe ajrosje optimale për kryerjen e aktivitetit mësimor.</p> <p><i>[Referenca: An_1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon realizimin e orëve të detyrueshme laboratorike.</p> <p>Pranë KUQ, në funksion të programeve të studimit të Fakultetit të Ekonomisë është Laboratori i Ekonomisë së Aplikuar i pajisur me kompjutera, projektor dhe lidhje interneti.</p> <p>Ky laborator shfrytëzohet nga studentët e programit të studimit për njohjen dhe aftësimin praktik në programin e kontabilitetit Financa 5, në paketat statistikore si Matlab, Eviews, Solver dhe Data Analysis të Microsoft Excel, si dhe për realizimin e detyrave të kursit dhe temës së diplomës.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë per ASCAL.pdf; An_3_9_2_Programi i lendëve në Master i Shkencave _Financë_202.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale, KUQ ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucioni dhe njësie kryesore me përfaqësues të institucioneve publike dhe të bizneseve private, të cilat u mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale studentëve të këtij programi studimi. Praktika profesionale zhvillohet gjatë semestrit të katërt me shkëputje nga procesi mësimor në mjediset e institucionit pritës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të miratuar nga palët.</p> <p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, ata konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për gjetjen e vendit të praktikës megjithëse shumica e kishte gjetur vetë, pasi ishin të punësuar që gjatë viteve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: An_1_8_Marëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brënda dhe jashtë vëndit.pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p><i>[Referenca: An_1_8_Marëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brënda dhe jashtë vëndit.pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Duke i'u referuar numrit aktual të studentëve të institucionit, mjediset e KUQ janë të mjaftueshme dhe të pajisuara me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor.

	<ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon realizimin e orëve të detyrueshme laboratorike. - Praktika profesionale e studentëve të këtij PS realizohet në mjediset e institucionit pritës, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3


Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve të programit “Master i Shkencave në Financë”, që zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe, përgjithësisht garanton marrjen e dijeve dhe njohurive sipas parashikimeve në lëndët e programit të studimit.</p> <p>Në takimin me pedagogët e këtij PS, GVJ konstatoi se ata ishin autorë të një pjese të literaturës bazë të lëndëve të këtij programi studimi dhe se e vinin në dispozicion të studentëve falas. Gjithashtu, GVJ mori konfirmimin se në fillim të çdo viti akademik, gjatë muajit tetor, pedagogët bëjnë rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve. Në Raportin Vjetor mbi Veprimtarinë e Departamentit të Financës për vitin akademik 2020-2021 nuk ndeshëm ndonjë raportim specifik lidhur me përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit, por në pjesën e raportit mbi kërkimin shkencor dhe projektet ku departamenti merr pjesë, rritja e numrit dhe cilësisë së botimeve nga ana e anëtarëve të departamentit përfshirë edhe tekstet dhe materialet ndihmëse shihet si një nga drejtimet e politikës së kërkimit shkencor të departamentit.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_Shkencor_në_Financë_per_ASCAL.pdf; An_3_17_Lista_e_librave_në_bibliotekë_për_programin_e_studimit_MSHFIN..pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>KUQ vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij kolegji universitar bibliotekën në katin e tretë dhe një sallë leximi në katin e parë të godinës së KUQ. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëllëj nga të gjithë studentët dhe personeli i KUQ, kundrejt një anëtarësimi me kartelë identifikimi dhe pa pagesë.</p> <p>Nga vizita në këtë bibliotekë, si dhe informacioni paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, rezultoi se biblioteka disponon literaturë</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>KUQ vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij kolegji universitar bibliotekën në katin e tretë dhe një sallë leximi në katin e parë të godinës së KUQ. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëllëj nga të gjithë studentët dhe personeli i KUQ, kundrejt një anëtarësimi me kartelë identifikimi dhe pa pagesë.</p> <p>Nga vizita në këtë bibliotekë, si dhe informacioni paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, rezultoi se biblioteka disponon literaturë</p>

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të KUQ si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë, revista dhe botime të institucioneve të tjera. Literatura gjendet kryesisht në formatin tradicional (kopje fizike letër), por për disa lëndë edhe në formën elektronike në CD dhe DVD. Aktualisht Biblioteka nuk e ofron shërbimin e librarisë online.</p> <p>GVJ konstatoi se Biblioteka dispononte kopje të librave që rekomandohen në literaturën e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë_per ASCAL.pdf; An_3_17_Lista e librave në bibliotekë për programin e studimit MSHFIN..pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KUQ nuk ofron shërbimin e bibliotekës online, por mori konfirmimin që po punohet për të mundësuar këtë shërbim falas për studentët dhe personelin akademik.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me 5 kompjutera, që mund të përdoren nga studentët për të shfrytëzuar literaturën e bibliotekës në formatin elektronik (CD dhe DVD) dhe për të hulumtuar në internet në funksion të realizimit të detyrave të kursit dhe temës së diplomës.</p> <p>Siç u përmend edhe më sipër biblioteka ende nuk ofron shërbimin e bibliotekës online.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Shërbimi i bibliotekës ofrohet nga e hëna deri të premte, në intervalin 08.00-17.00, në përputhje me nevojat e studentëve të këtij programi studimi, që e zhvillojnë mësimin kryesisht pasdite, por edhe të studentëve të programeve të tjera.</p> <p><i>[Referenca: An_1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës..pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit,</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ vlerëson se raportimi lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të saj, është i kufizuar dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.</p> <p>Rregulloja e brendshme e bibliotekës parashikon aspektet kryesore të aktivitetit të shërbimit të bibliotekës së KUQ dhe në nenin 15 përcakton se një nga detyrat e saj është mbledhja, ruajtja dhe pasurimi i fondit të vet me materiale që kanë interes për veprimtarinë e Kolegjit.</p> <p>Në takimin me pedagogët e këtij PS, GVJ konstatoi se ata ishin autorë të një pjese të literaturës bazë të lëndëve të këtij programi studimi dhe se e vinin në dispozicion të studentëve falas. Gjithashtu, GVJ mori</p>

<p>duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>konfirmimin se në fillim të çdo viti akademik, gjatë muajit Tetor, pedagogët bëjnë rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve. Në Raportin Vjetor mbi Veprimtarinë e Departamentit të Financës për vitin akademik 2020-2021 nuk ndeshëm ndonjë raportim specifik lidhur me përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit, por në pjesën e raportit mbi kërkimin shkencor dhe projektet ku departamenti merr pjesë, rritja e numrit dhe cilësisë së botimeve nga ana e anëtarëve të departamentit përfshirë edhe tekstet dhe materialet ndihmëse shihet si një nga drejtimet e politikës së kërkimit shkencor të departamentit.</p> <p>Në dokumentin e Planit strategjik të zhvillimit të KUQ (2021-2026), pika e tretë e planveprimit për financimin përfshin pasurimin e fondit të librit. GVJ rekomandon përfshirjen e institucionit në rrjetin e bibliotekave online përmes projekteve apo marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të rritjes së cilësisë dhe performancës së përgjithshme të personelit akademik dhe të studentëve.</p> <p>[Referenca: An_1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës..pdf; An_1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"..pdf; An_3_0_Raporti Vlerësimi të Brendshëm Master Shkencor në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk ka ndonjë raportim specifik lidhur me përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. - Biblioteka e KUQ dispononte kopje të librave që rekomandohen në literaturën e programit të studimit. - Biblioteka e KUQ nuk ofronte shërbimin e bibliotekës online. - Nuk ka ndonjë raportim specifik lidhur me cilësinë e fondit të bibliotekës apo shkallën e shfrytëzimit të saj. 								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 1265 742 1332">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="742 1265 981 1332">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="981 1265 1189 1332">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 1265 1415 1332">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se institucioni përdor kryesisht sistemin tradicional të administrimit të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, të bazuar në dokumentacionin në formatin letër dhe elektronik dhe të dosjeve përkatëse, të kombinuar përsa i takon komunikimit edhe me përdorimin e emaileve personale dhe të rrjeteve sociale.</p>



	<p>Sipas rregulloreve të institucionit, informacioni lidhur me studentët që nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre sipas programit të studimit, administrohet nga Sekretaria Mësimore, në formatin letër dhe elektronik; si dhe ruhet në dosjet përkatëse në arkivën e KUQ.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen e dy studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. GVJ konstatoi plotësinë e dosjeve të studentëve të verifikuar dhe të dy regjistrave kryesorë, por konstatoi mospërputhje lidhur me regjistrin e notave. Së pari ky regjistër nuk ishte sipas formatit të ri të miratuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), për arsye vonesash administrative sipas komenteve të sekretarisë. Së dyti, nga verifikimi i procesverbaleve të notave për vitin akademik 2020-2021 rezultoi që lëndët në këtë regjistër ishin paraqitur sipas programit të vjetër mësimor. Vlen të theksohet se në RVB dhe në takimet zhvilluara u komentua që ndryshimet në programin mësimor janë zbatuar që në vitin akademik 2020-2021.</p> <p><i>[Referenca: An_1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore..pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në takimin me përfaqësuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokolit dhe Arkivës (ZBNJPA), GVJ u informua se kjo strukturë ndër të tjera, merrej dhe me administrimin e informacionit të përgjithshëm mbi personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi në formën e dosjes personale të personelit.</p> <p>Informacioni lidhur me aktivitetin mësimor dhe shkencor të personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit administrohet nga njësia bazë (ngarkesa, syllabuset, pjesëmarrjet në konferenca, artikujt etj).</p> <p>Gjatë vizitës, GVJ konstatoi se përfaqësuesi i ZBNJPA ishte i punësuar rishtas dhe ndihmohej në proces nga sekretaria mësimore, që administronte e vetme edhe sekretarinë. Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjet personale të dy pedagogëve të programit të studimit dhe konstatoi se dosjet ishin kryesisht të plotësuara me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomat & çertifikatat, librezat shëndetësore etj (në një dosje mungonte kontrata e rinovuar).</p> <p><i>[Referenca: An_1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll-Arkivit..pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master Shkencor në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, sistemi i menaxhimit të informacionit është tradicional dhe aksesit realizohet përmes përfaqësuesve të strukturave/zyrave përkatëse, bazuar në dokumentacionin letër të</p>

<p>gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>kombinuar me komunikimet me email dhe publikimeve sipas natyrës së informacionit në rrjetet sociale dhe faqen zyrtare të internetit.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë mësimi është zhvilluar online dhe institucioni ka përdorur platformat si Google Classroom, Google Hangout, Google Meeting dhe ZOOM, si dhe një udhëzues të posaçëm për të mundësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit mes personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>[Referenca: An_1_23_Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimi on-line ..pdf; An_3_0_Raporti Vlerësimi te Brendshem Master Shkencor në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit brendshëm të informacionit të KUQ është tradicional dhe aksesit realizohet përmes përfaqësuesve të strukturave/zyrave përkatëse, bazuar në dokumentacionin letër të kombinuar me komunikimet me email dhe publikimeve sipas natyrës së informacionit në rrjetet sociale dhe faqen zyrtare të internetit.</p> <p>Për shkak të numrit të vogël të studentëve, GVJ konstaton se ky sistem funksionon sipas nivelit të hierarkisë së strukturave, por nuk mundëson përdorimin e integruar të platformave apo moduleve të dedikuara, si dhe nuk garanton monitorime dhe raportime në kohë reale (personeli ndihmës është në nivele minimale).</p> <p>Në mungesë të një sistemi menaxhimi të integruar e bashkëkohor, pavarësisht numrit të vogël të studentëve, GVJ rekomandon rritjen e personelit ndihmës dhe administrativ për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe të dokumentacionit që administron institucioni.</p> <p><i>[Referenca: An_1_23_Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimi on-line ..pdf; An_3_0_Raporti Vlerësimi te Brendshem Master Shkencor në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga vizita e faqes zyrtare në internet të KUQ, gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti, GVJ konstatoi se informacioni lidhur me programet e studimit, personelin akademik, studentët dhe aktivitetet e tjera ishte në nivele modeste ndërsa mungonte informacioni lidhur me kuadrin rregullator të institucionit (statuti, rregulloret) si dhe orari mësimor. Gjithashtu, u konstatua se informacioni publikohet vetëm në gjuhën shqipe. Në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ u informua se faqja zyrtare në internet e institucionit ishte në proces riorganizimi.</p> <p><i>[Referenca: https://qiriaz.edu.al/; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i menaxhimit të informacionit është tradicional, nuk mundëson integrim platformash/modulesh të dedikuara, si dhe nuk garanton monitorimin dhe raportimin në kohë reale. - Pranë Sekretarisë Mësimore, Regjistri i notave ishte sipas formatit të vjetër dhe për vitin akademik 2020-2021 lëndët i takonin programit mësimor të vjetër.

	- Në faqen zyrtare në internet të KUQ, informacioni është minimal dhe publikohet vetëm në gjuhën shqipe.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas statutit të KUQ, projekt buxheti vjetor hartohet në nivel institucioni nga Administratori mbi bazën e propozimeve të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor e afatmesëm të tij (neni 24 pika 6/a). Në përfundim të çdo viti akademik, Administratori i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të KUQ (neni 24 pika 6/e).</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KUQ nuk harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për PS por ka hartuar një plan financiar për vitet akademike 2020-2022 për këtë program studimi, një plan buxhetor të KUQ për vitet akademike 2020-2022 dhe planin buxhetor për vitet 2018-2025. Të tre dokumentat janë përgatitur nga Zyra e Financës e KUQ dhe llogaritja e kostos për student bëhet në nivel institucioni si raport i shpenzimeve gjithsej me numrin total të studentëve.</p> <p>[Referenca: An_3_18_Plani i financimit të programit të studimit MSHFIN..pdf; An_1_14_3_Plani Buxhetor i Kolegjit Universitar "Qiriazi" 2019-2021..pdf; An_1_14_1_Plani buxhetor (2018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit..pdf; An_3_0_Raporti Vlerësimi te Brendshem Master Shkencor në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në dokumentat e mësipërm, të ardhurat u referohen të ardhurave nga tarifat që paguajnë studentët dhe shpenzimet janë klasifikuar sipas natyrës në: shpenzime për materiale, për pagat dhe sigurimet, shpenzime për amortizimin dhe shpenzime të tjera të aktivitetit. Në një paragraf të veçantë evidentohen investimet e kryera apo ato në proces.</p> <p>Nga analiza e dokumentave të mësipërm GVJ konstaton sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokumentave u mungon data e hartimit të tyre. ▪ Për dy dokumentet e para ka një përputhje totale informacioni, me përjashtim të dy paragrafëve në faqen 4 që në dokumentin e parë i referohen programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” dhe në dokumentin e dytë i referohen Fakultetit të Ekonomisë. ▪ Nuk jepet asnjë kriter i qartë vlerësimi i përdorur për sa i takon elementëve të parashikuar në këto dokumente, si psh numri i parashikuar i studentëve apo të ardhurat në të ardhmen. ▪ Për vitin akademik 2024-2025 në dokumentin e dytë dhe vitin akademik 2023-2024 në dokumentin e tretë, rezultati buxhetor parashikohet negativ (me humbje 13‘135‘067 lekë). <p>GVJ vlerëson se informacioni i paraqitur në këto dokumenta nuk është i plotë dhe nuk përputhet me objektivat e një plani financiar në shërbim të realizimit dhe mbarëvajtjes së një programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: An_3_18_Plani i financimit të programit të studimit MSHFIN..pdf; An_1_14_3_Plani Buxhetor i Kolegjit Universitar “Qiriazi” 2019-2021..pdf ; An_1_14_1_Plani buxhetor (2018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit..pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>KUQ është institucion jo publik i arsimit të lartë në pronësi të shoqërisë tregtare “SEVASTI & PARASHQEVI QIRJAZI” shpk., për pasojë aktiviteti tregtar rregullohet edhe nga Ligji Nr.9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, i ndryshuar. Shoqëria ka detyrim ligjor përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjin Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ si dhe publikimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).</p> <p>Sipas Statutit, Administratori i KUQ ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ konstaton se pjesa e informacionit financiar të paraqitur në dokumentat tip raporte vjetore mbi veprimtarinë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Financës përkon me informacionin financiar të paraqitur në planin buxhetor të përmendur në kriterin 2 & 3 më sipër.</p> <p>Gjithashtu institucioni deklaron se nuk kryen auditim ligjor (të jashtëm), por kryen auditim të brendshëm dhe nuk shprehet lidhur me periodicitetin e kryerjes së tij. GVJ nuk iu vu në dispozicion asnjë dokument lidhur me aktivitetin e auditimit të gjendjes financiare të KUQ përveç RVB.</p>

[Referenca: An_2_14_Raporti_vjetor_mbi_veprimtarine_kerkimore_shkencore..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_Shkencor_në_Financë_per_ASCAL.pdf; An_3_5_Analizë_vjetore_e_Departamentit_të_Financës(2020-2021).pdf; vizita në institucion]

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.

Sipas Statutit të KUQ, Bordi i Administrimit ndër të tjera garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga veprimtaria e tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit (neni 10 pika 6/a & 6/c). Në planin strategjik të KUQ, për periudhën 2021-2026 theksohet angazhimi për fuqizimin e financave ndër të tjera përmes: përmirësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të financave të institucionit; rritjes së të ardhurave duke nxitur dhe duke u përfshirë në projekte kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare; ofrimit të këshillimit dhe shërbimeve të tretëve; përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve duke rritur transparencën dhe efikasitetin e tyre etj.

Megjithatë Pasqyrat Financiare të Shoqërisë tregtare “SEVASTI & PARASHQEVI QIRJAZI” shpk, të publikuara në QKB flasin për një rezultat ekonomik negativ (humbje) të tre viteve të fundit kalendarike (2019-2021). Gjithashtu GVJ nuk konstatoi ndonjë analizë sasiore mbi ecurinë financiare apo mbi planifikimin e ndërhyrjeve për përmirësimin e situatës financiare në KUQ (analizë sasiore të detajuar të këtij programi studimi apo sipas cikleve të studimit) prandaj rekomandon realizimin e një analize të tillë në funksion të një mirëadministrimi të qëndrueshëm, afatgjatë dhe efektiv të institucionit, por edhe të programeve të studimit që ai mbulon.

[Referenca: An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_Shkencor_në_Financë_per_ASCAL.pdf; <https://qkb.gov.al/>; vizita në institucion]

Konkluzione

GVJ konstaton se:

- KUQ nuk harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.
- KUQ si shoqëri tregtare duhet t'i nënshtrohet auditimit ligjor.
- GVJ nuk iu vu në dispozicion asnjë dokument lidhur me aktivitetin e auditimit të gjendjes financiare të KUQ përveç RVB.
- Sipas Pasqyrave Financiare të publikuara në QKB, shoqëria rezulton me humbje në tre vitet e fundit kalendarike.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe Statutin e KUQ. Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej edhe nga kërkesat (nënet) specifike të Statutit të KUQ dhe të rregulloreve respektive të njësisë kryesore dhe njësisë bazë.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ.pdf; An_1_3_Rregullore_e_Kolegjit_Universitar_„Qiriazi_”_(KUQ).pdf; An_2_3_Rregullore_e_Fakultetit_të_Ekonomisë..pdf; An_3_4_Rregullore_e_Programit_te_Studimit_Finance_MSHF.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në Statutin dhe në rregulloret e KUQ, parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. Sipas parashikimeve në Statut dhe në rregulloret e sipërcituara, Departamenti i Financës propozon çdo vit kriteret e përzgjedhjes në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë” dhe kuotat e pranimit të studentëve në përputhje me kapacitetet në dispozicion dhe me standardet e cilësisë, të cilat më pas miratohen nga Dekanati i FE dhe në nivel institucioni nga Senati Akademik i KUQ.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Këto kriteret dhe kuota të pranimit, pas marrjes së miratimit sipas kuadrit rregullator, bëhen publike nga KUQ përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e dytë të studimeve, përmes publikimeve në ambientet e universitetit, fletëpalosjeve dhe guidave, publikimeve në faqen zyrtare web të universitetit, në mediat lokale të komunikimit, në rrjetet sociale, si dhe takimeve të drejtpërdrejta me të interesuarit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat	[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ.pdf; An_1_3_Rregullore_e_Kolegjit_KUQ.pdf; An_2_3_Rregullore_e_Fakultetit_të_Ekonomisë..pdf; An_3_4_Rregullore_e_Programit_te_Studimit_Finance_MSHF.pdf; https://qiriazi.edu.al/kriteret-e-pranimit-te-studenteve/; vizita në institucion]

e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.									
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se kuadri rregullator i KUQ nuk ka parashikime specifike për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara por respekton kuadrin ligjor në fuqi dhe Udhëzimet e MAS. Gjithashtu, në Statutin e KUQ parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e përgjithshme të programit të studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS, pa vendosur kriteret e tjera specifike.								
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ.pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; vizita në institucion]								
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitë në KUQ, GVJ konstatoi se parashikimet lidhur me politikat e bursave në kuadrin rregullator të institucionit janë në nivele të përgjithshme, kryesisht përmes diskutimit të veprimtarisë financiare në mbledhjet e përbashkëta të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. GVJ konstatoi edhe nga publikimi në faqen zyrtare në internet të KUQ, anagazhimin e institucionit për të rritur cilësinë në programet Bachelor përmes aplikimit të bursave për studentët cilësorë si dhe aplikimin e tarifave të reduktuara për studentët që regjistrohen në raundin e parë. Gjithashtu, Bordi i Administrimit shqyrton edhe kërkesa të studentëve për reduktim tarife si shtresë në nevojë. [Referenca: An_1_15_Vendimi_i_Bordit_Administrativ_për_tarifa_dhe_bursa.pdf; https://qiriazhi.edu.al/apliko-per-burse/; vizita në institucion]								
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe Statutin e KUQ. - Kriteret dhe kuotat e pranimit, pas marrjes së miratimit sipas kuadrin rregullator, bëhen publike nga KUQ përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e dytë të studimeve. - Praktika aktuale e bursave e publikuar i referohet kryesisht studentëve të programeve Bachelor.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi të studimeve. Në Statutin e KUQ (neni 42), në Rregulloren e KUQ (Kreu X), në Rregulloren e Njesisë Kryesore (Kreu 10) jepet informacion i plotë lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe periudhave të mëparshme të studimit. Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, pranë Fakultetit të Ekonomisë, me vendim të Dekanatit të Fakultetit ngrihet një komision për Njohjen dhe Ekuivalentimin e Studimeve të kandidatëve për transferim studimesh dhe për program të dytë studimi, i cili diskuton dhe propozon kriteret e këtij vlerësimi bazuar në kuadrin rregullator të KUQ dhe Udhëzimet e MAS.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e regjistrimit pranë KUQ, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik i Departamentit të Financës, nga Koordinatori i Programit i FE dhe nga specialistja e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_1_Statuti i KUQ.pdf; An. 1_3_Rregullore e KUQ.pdf; An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An. 3_4_Rregullore e Programit të Studimit Finance_MSHF.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në përputhje me parashikimet e Statutit dhe të Rregullores së KUQ, në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe të këtij Programi Studimi jepet informacion i plotë mbi vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin e provimit të zhvilluar për lëndën në përfundim të semestrit. Programet e lëndëve (syllabuset) janë të hartuara në bazë të rregulloreve të institucionit dhe udhëzimit të MAS dhe përmbajnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në këtë program studimi. Këto kritere dhe procedura u komunikohen studentëve nga pedagogët gjatë orës së parë të mësimit, ku u paraqitet programi i lëndës.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi final rezulton përgjithësisht i harmonizuar mes lëndëve dhe përcaktohet në masën:</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 40% nga vlerësimi i aktiviteteve gjatë semestrit akademik ku përfshihen frekuentimi, aktivizimi në seminare dhe kontrollet e tjera si provim i ndërmjetëm apo teste, detyra dhe projekte kursi; ▪ 60% nga vlerësimi në provimin në fund të semestrit. <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Financë” parashikohet që në përfundim të programit, studenti duhet të përgatisë një punim diplome (neni 16 pika 2). Procedura e përgatitjes së punimit të diplomës dhe e diplomimit sqarohet në Rregulloren e Departamentit të Financës.</p> <p>Për këto aspekte, studentët informohen edhe nga Koordinatorin e Programit të FE. Në fillim të semestrit të tretë të programit të studimit, departamenti i Financës përcakton një listë të temave të diplomës bazuar në fushat e studimit të departamentit dhe Përgjegjësi i Departamentit më pas bën miratimin e pedagogut udhëheqës për çdo student.</p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion edhe një udhëzues me kërkesa që duhen mbajtur parasysh gjatë përgatitjes dhe për mbrojtjen e punimit të diplomës. Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët ishin të mirë informuar lidhur me këto kritere dhe procedura.</p> <p>GVJ konstaton se parashikimet në Rregulloren e Programit të Studimit si dhe Dokumenti me kërkesat për punimin e diplomës janë shumë të përgjithshme dhe nuk bëjnë dallimin e duhur mes cikleve dhe programeve të studimit. Prandaj, GVJ rekomandon rishikimin e tyre dhe personalizimin në funksion të Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë.</p> <p><i>[Referenca: An_2_3_Rregullore_e_Fakultetit_të_Ekonomisë.pdf; An_2_10_Kërkesat_për_për_përgatitjen_e_punimit_të_diplomës_.pdf; An_3_4_Rregullore_e_Programit_të_Studimit_Finance_MSHF.pdf; vizita_në_institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u informua se në çdo vit akademik, përmes Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë, KUQ merr pjesë në aktivitete, panire dhe organizon vizita në institucion ku maturantët dhe studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambientet dhe mundësitë që ofron KUQ. Gjithashtu, në faqen zyrtare në internet publikohen informacione të përgjithshme mbi programet e studimit dhe njoftime të tjera informuese për studentët e ardhshëm.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti_Vleresimi_të_Brendshëm_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; https://qiriaz.edu.al/master/; vizita_në_institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - KUQ vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.

	<ul style="list-style-type: none"> - KUQ vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në PS, përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës. - KUQ merr pjesë dhe organizon aktivitete informuese për studentët. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet me regjistrimin e studentëve pranë KUQ nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMJPKK), si dhe përmes publikimit të informacionit në ambientet e institucionit dhe në rrjetet sociale. Gjithashtu, këtë informacion studentët e marrin edhe në takimin prezantues me drejtuesit e KUQ dhe personelin akademik në ditën e parë të mësimit për vitin akademik.</p> <p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve planin mësimor dhe programet e lëndëve (syllabuset), ku paraqitet informacioni mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit. Gjatë orës së parë të çdo lënde, pedagogët prezantojnë studentët me objektivat e lëndës, njohuritë që do të marrin në lëndën përkatëse, literaturën ku do të mbështeten dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se informimi i studentëve mbi mundësitë e punësimit dhe orientimi drejt tregut të punës realizohet nga Koordinatorin e Programit të FE, specialistja e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMJPKK) dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: An_2_9_1_Vendimi për emrimin dhe detyrat e Koordinatorit të programit MSHFIN.pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se informimi i studentëve mbi mundësitë e punësimit dhe orientimi drejt tregut të punës realizohet nga Koordinatorin e Programit të FE, specialistja e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMJPKK) dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: An_2_9_1_Vendimi për emrimin dhe detyrat e Koordinatorit të programit MSHFIN.pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Koordinatori i Programit të FE, specialistja e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMJPKK) dhe pedagogët e Departamentit përgjegjës për programin e studimit, u mundësojnë studentëve informacion të përditësuar edhe lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Siç u përmend edhe më herët, sistemi i brendshëm i informacionit është tradicional, KUQ nuk disponon aktualisht një platformë të integruar të informacionit dhe informacioni në faqen zyrtare në internet ishte në proces riorganizimi. Kjo kufizon përdorimin e informacionit në distancë nga studentët.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimi mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet gjatë regjistrimit të studentëve pranë KUQ, si dhe përmes publikimit të informacionit në ambientet e institucionit dhe në rrjetet sociale. - Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit. - Koordinator i Programit të FE, specialistja e ZMJPKK dhe pedagogët e Departamentit përgjegjës për programin e studimit, u mundësojnë studentëve informacion të përditësuar edhe lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi si dhe mbi mundësitë e punësimit dhe orientimin drejt tregut të punës. - Përdorimi në distancë i informacionit është i kufizuar pasi KUQ nuk disponon aktualisht një platformë të integruar të informacionit dhe informacioni në faqen zyrtare në internet ishte në proces riorganizimi. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se KUQ mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të</p>

studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi.

Sekretaria mësimore e KUQ mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre.

Gjatë vizitës në sekretari, GVJ konstatoi se dy nga regjistrat, Regjistri themeltar dhe Regjistri i lëshimit të diplomave, janë të formatuar sipas standardeve shtetërore ndërsa Regjistri i arritjeve akademike rezultoi sipas formatit jo-të përditësuar (për motive vonesash administrative me QSHA sipas sekretarisë).

Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë” dhe konstatoi plotësinë e tyre.

Gjatë këtij procesi GVJ konstatoi që për vitin akademik 2020-2021, procesverbalet e provimeve të lëndëve të këtij programi studimi ishin sipas programit mësimor të vjetër dhe jo të rishikuar sipas rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit në vlerësimin e fundit të vitit 2019. GVJ kërkoi si informacion shtesë orarin e publikuar të mësimit të dy viteve të fundit akademike, por ky informacion rezultoi jo i plotë dhe me pasaktësi.

Në vijim paraqiten të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për periudhën 2019-2022:

Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Transferime	Të diplomuar
2019-2020	3 studentë	-	4 studentë
2020-2021	6 studentë	3 studentë	4 studentë
2021-2022	7 studentë	2 studentë	në proces

Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi në harkun kohor 2019-2021 janë të regjistruar me numër matrikullimi me përjashtim të një studenti (viti akademik 2020-2021) që ka rezultuar me probleme të dokumentacionit dhe për pasojë nuk ka vijuar frekuentimin e programit të studimit.

[Referenca: An_2_14_1_Student të regjistruar në vite në FE..pdf; An_3_0_Raporti Vlerësimi të Brendshëm Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe

Sistemi i brendshëm i informacionit i KUQ është tradicional. Bazuar në kuadrin rregullator të KUQ, Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arshivës, Rregullore e Departamentit të Financës këto struktura janë përgjegjëse

<p>lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>për informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre sipas funksioneve që mbulojnë. Pranë këtyre strukturave, informacioni disponohet dhe ruhet kryesisht në formatin letër, por edhe elektronik. Pavarësisht mungesës së një platforme të integruar të informacionit në KUQ, numri i ulët i studentëve të regjistruar mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja e tyre jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>[Referenca: An_1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll-Arkivit..pdf; An_1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore..pdf; An_3_3_Rregullore e Departamentit të Financës..pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ nuk konstatoi ndonjë akt institucional lidhur me kontrollin periodik pranë strukturave që merren me menaxhimin apo ndonjë vlerësim periodik të saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë përkatëse përveç raporteve të përgatitura nga Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</p> <p><i>[Referenca: An_1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC (2020-2021) ..pdf; An_3_0_Raporti Vlerësimi të Brendshëm Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se pjesë e raportit vjetor të Departamentin e Financës ishte dhe statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar, kalueshmërinë sipas viteve, si dhe numrin e të diplomuarve në programet e studimit që ofrohen nga ky departament. Raporti është kryesisht përshkrues i veprimtarisë së departamentit gjatë vitit akademik përkatës dhe nuk përfshin evidencë problematikash apo masa konkrete të marra në drejtim të përmirësimit të situatës.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vlerësimi të Brendshëm Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; An_3_5_Analizë vjetore e Departamentit të Financës (2020-2021).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - KUQ mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. - Për vitin akademik 2020-2021 proceverbalet e provimeve të lëndëve të këtij programi studimi ishin sipas programit mësimor të vjetër dhe jo të rishikuara sipas rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit në vlerësimin e fundit të vitit 2019.

	<ul style="list-style-type: none"> - Mungon një platformë e integruar e informacionit, por numri i ulët i studentëve të regjistruar mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. - Përveç raportit të NJSBC, pranë KUQ nuk ka ndonjë akt institucional mbi kontrollin periodik pranë strukturave që merren me menaxhimin. - Departamenti mban statistika të thjeshta dhe nuk bën një analizë të problemeve dhe masave të nevojshme për përmirësimin e situatës. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.5


Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se KUQ ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës, si dhe në Komisionet e Përherëshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të institucionit.</p> <p>Gjithashtu, studentët kanë përfaqësuesin e tyre edhe pranë Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të KUQ si dhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>Në nenin 48 (pikat 5 & 6) të Statutit të KUQ parashikohet e drejta e studentëve për të dhënë mendime dhe bërë propozime mbi: planet dhe programet mësimore; hapjen e programeve të reja; rregulloret e institucionit; cilësinë e shërbimeve dhe tarifrat e shkollimit; si dhe për zhvillimin e veprimtarive të tjera kulturore artistike. Gjithashtu, parashikohet mbështetja për Këshillin Studentor përmes financimit të veprimtarive të tij nga buxheti i parashikuar i KUQ.</p> <p><i>[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; 11.Vendimet_për_krijimin_e_strukturave_të_KUQ.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta</p>	<p>Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të garantuara nga statuti dhe rregulloret e KUQ, GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe pyetësorin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin.</p>

<p>dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Pas përpunimit të pyetësorëve, nga NJSBC, rezultatet përfshihen në analizën dhe raportin vjetor që përgatit kjo njësi, si dhe u komunikohet të gjitha strukturave të institucionit.</p> <p>Në takimin me Përgjegjësen e Departamentit të Financës, GVJ u informua se realizimi i orarit mësimor të këtij programi studimi në oraret pasdite gjatë javës dhe ditën e shtunë (pavarësisht parashikimit ndryshe në kuadrin rregullator të KUQ) ishte reflektim i sugjerimeve të ardhura nga studentët me qëllim përmirësimin e angazhimit të tyre pranë programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: An_2_13_Pyetsorët për studentët në FE..pdf; 22.Raporti i analizës së pyetesorit të studentëve që diplomohen.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e KUQ, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e Departamentit të Financës, në nenet përkatëse (përkatësisht nenet 65, 67 dhe 35) parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve ose vlerësimin në provim, kundrejt një kërkesë me shkrim. Nga shqyrtimi i këtyre neveve, GVJ konstatoi disa mospërputhje. Sipas Rregullores së KUQ ankesa i drejtohej Dekanit, ndërsa sipas Rregulloreve të njësisë përgjegjëse/bazë ankesa i drejtohet Përgjegjëses së Departamentit dhe për dijeni Dekanit të FE. Gjithashtu, në këto dy të fundit nuk ka përcaktime kohore (afate) për kryerjen e ankesës.</p> <p>Në Rregulloren e KUQ, përcaktohet që ankesa për procesin duhet të bëhet menjëherë pas provimit, ndërsa ankesa për vlerësimin duhet të paraqitet brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit për rezultatin në provim nga sekretaria mësimore. Pas sqarimeve të nevojshme me përgjegjësen e departamentit, komisionin e provimit dhe studentin, në rast se ankesa është e drejtë, studentit i jepet e drejta të rijapë provimin me një komision të ri në një datë tjetër, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.</p> <p>GVJ sugjeron që Rregulloret e institucionit të jenë të harmonizuara dhe të specifikojnë më qartë procedurën dhe afatet e ankimimit.</p> <p>Gjithashtu, studentët mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve edhe përmes pyetësorëve përkatës të realizuar në fund të çdo semestri nga NJSBC, në nivel institucioni.</p> <p><i>[Referenca: An_1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi ” (KUQ)..pdf; An_2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë..pdf; An_3_3_Rregullore e Departamentit të Financës..pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - KUQ ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës, si dhe në Komisionet e Përherëshme, në NJSBC dhe në GVB në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të institucionit.

	<ul style="list-style-type: none"> - GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe pyetësorin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. - Kuadri rregullator i KUQ, parashikon të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe/ ose vlerësimin në provim por këto akte rregullatore duhet të jenë të harmonizuara dhe të specifikojnë më qartë procedurën dhe afatet e ankimit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në Rregulloren e KUQ (nenet 101 & 104), Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimin dhe Këshillimit për Karrierë (ZMJPKK) janë përcaktuar si njësi mbështetëse të institucionit në shërbim edhe të informimit të studentëve. Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore përfaqësohej nga punonjësja e vetme ndërsa ZMJPKK përfaqësohej nga drejtuesja dhe dy specialistet.</p> <p>Gjithashtu, Koordinatorin e Programit i FE së bashku me stafin akademik të programit të studimit informojnë studentët mbi të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin mësimor.</p> <p><i>[Referenca: An_1_3_Rregullore e KUQ.pdf; An_1_9_Rregullore, e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.pdf; An_1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore..pdf; An_2_9_1_Vendimi për emrimin dhe detyrat e Koordinatorit të programit MSHFIN.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në nenin 101 të Rregullores së KUQ, Sekretaria Mësimore ka si funksion regjistrimin dhe mbajtjen e bazës së të dhënave të studentëve, mbajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit lidhur me ecurinë mësimore dhe diplomimin e tyre, përgatitjen dhe dhënien e vërtetimeve e konfirmimeve përkatëse.</p> <p>Funksionet e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, e Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës, sipas parashikimeve të nenit 104 të Rregullores së KUQ, integrojnë fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe subjekte të tjera brenda dhe jashtë vendit me shërbimet e këshillimit të studentëve për pranimin pranë programeve të KUQ, ecurinë dhe më pas, në përfundim të studimeve, për punësim dhe mundësi rritjeje në karrierë.</p>



	<p>Gjithashtu, Koordinatorin e Programeve të Studimit të FE së bashku me personelin akademik të Departamentit të Financës luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, rregulloret, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ u informua se për shkak të numrit të ulët të studentëve Koordinatorin mbulon të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i Ekonomisë.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3_Rregullore e KUQ.pdf; An. 1_9_Rregullore, e Zyrës së Marrëdhënies me Jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.pdf; An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore..pdf; An. 2_9_1_Vendimi për emrimin dhe detyrat e Koordinatorit të programit MSHFIN.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në takimin me përfaqësueset e Zyrës së Marrëdhënies me Jashtë, e Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMJPKKK), gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kjo zyrë realizon aktivitetin e saj bazuar në planin vjetor të punës në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator të KUQ.</p> <p>Specialistja përgjegjëse për këshillimin e karrierës dhe jetës studentore, me ndihmën edhe të sekretarisë mësimore, përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe komunikimit me e-mail, u jep studentëve informacion mbi planet mësimore, kurrikulat dhe diplomatat që ofron KUQ, orienton studentët për të hyrë në tregun e punës, ndihmon në gjetjen e vendeve për realizimin e praktikave mësimore bazuar në marrëveshjet e lidhura nga institucioni, mban të dhëna për punësimin e të diplomuarve, informon lidhur me organizimin e aktiviteteve social-kulturore të Këshillit Studentor të KUQ dhe në bashkëpunim me të etj.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjithashtu, ZMJPKK me specialisten përgjegjëse ka për detyrë të mbështesë studentët e diplomuar në mënyrë që ata të orientojnë dhe të përshtaten më mirë në tregun e punës. Për këtë qëllim, zyra mbledh të dhëna për të diplomuarit përmes pyetësorit për studentët alumni, ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta.</p> <p><i>[Referenca: An. 1_3_Rregullore e KUQ.pdf; An. 1_9_Rregullore, e Zyrës së Marrëdhënies me Jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.pdf; Aneks. 2_13_2 Pyetësori për studentet ALUMNI.pdf; 18.Plani i punës i zyrës së Marrëdhënies me Jashtë e Këshillim.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në dispozicion të informimit të studentëve janë Sekretaria Mësimore, Zyra e Marrëdhënies me Jashtë, Pranimit dhe Këshillimit të Karrierës si dhe Koordinatorin e Programeve të FE dhe personeli akademik i KUQ. - Koordinatorin mbulon të gjitha programet e studimit që ofron FE.


	- ZMJPKK mbledh të dhëna për të diplomuarit përmes pyetësorit për studentët alumni.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi angazhimin e personelit akademik të këtij programi studimi për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në fushat e tyre studimore dhe kërkimore.</p> <p>Megjithatë duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ nuk konstatoi udhëzues të specializuar të KUQ për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Dy dokumentat e cilësuar në RVB, “Udhëzuesi për kualifikimin e personelit akademik“ dhe “Përdorimi i TI dhe Sistemi informatik në funksion të mësimdhënies“, janë shumë të përgjithshëm dhe kanë nevojë për përditësim me realitetin praktik të KUQ.</p> <p><i>[Referenca: An_1_13_Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik të KUQ.pdf; An_1_13_1 Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies..pdf; An_3_0_Raporti Vlerësimi të Brendshëm Master i Shkencave në Financë për ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se institucioni konsideron NJSBC si strukturë përgjegjëse edhe për zhvillimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik.</p> <p>Aktualisht tre prej anëtarëve të kësaj strukture ishin dhe anëtarë të GVB të këtij programi studimi. GVJ vlerëson se kjo qasje është e pamjaftueshme, sjell një mbivendosje të detyrave dhe kompetencave për NJSBC dhe ekspozon anëtarët e saj ndaj riskut të konfliktit të interesit.</p>

	<p>Gjithashtu GVJ konstaton se NJSBC merret kryesisht me monitorimin formal të procesit mësimor si respektimi i formateve të syllabuseve, fillimi/mbarimi në kohë i orës mësimore, kalendari i provimeve etj por nuk merret me vlerësim të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe nuk ka zhvilluar ndonjë mekanizëm monitorimi apo vlerësimi periodik të aftësive mësimdhënëse (përveç pyetësorit të studentëve).</p> <p>GVJ rekomandon që edhe njësia kryesore dhe njësia bazë duhet të shihen dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive si struktura përgjegjëse për zhvillimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik.</p> <p><i>[Referenca: An_0_1_1_Vendimi per RVB FIN.pdf; 11.Vendimet për krijimin e strukturave të KUQ.pdf; An_1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC (2020-2021) .pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; ; 21.Plani i aktiviteteteve të zyres NJSBC për vitin akademik 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Siç u përmend edhe në pjesën V. Studentët dhe Mbështetja e tyre, kadri rregullator i KUQ u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC, në nivel institucioni.</p> <p>Gjithashtu, parashikohet edhe e drejta e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve ose vlerësimin në provim, kundrejt një kërkese me shkrim që i drejtohet Përgjegjësës së Departamentit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës dhe vendimi i marrë bëhen pjesë e dokumentacionit të ruajtur në dekanat.</p> <p><i>[Referenca: An_1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi ” (KUQ)..pdf; An_2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë..pdf; An_3_3_Rregullore e Departamentit të Financës..pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se raporti vjetor i NJSBC u paraqitet strukturave drejtuese të institucionit dhe përmes tyre informohet në mënyrë konfidenciale edhe personeli akademik me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, por nuk ndeshi ndonjë publikim qoftë edhe në format të përmbledhur të rezultateve të vlerësimeve të kryera nga kjo njësi.</p> <p>Gjithashtu GVJ nuk konstatoi ndonjë shembull promovimi të praktikave pozitive me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie.</p>



	[Referenca: An_1_4_1_Raporti_vjetor_i_NJSBC_(2020-2021)_..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; vizita në institucion]		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk ka udhëzues të specializuar të KUQ për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. - Kuadri rregullator i KUQ u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. - Institucioni konsideron NJSBC si strukturë përgjegjëse edhe për zhvillimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, por NJSBC nuk ka zhvilluar ndonjë mekanizëm monitorimi apo vlerësimi periodik të aftësive mësimdhënëse (përveç pyetësorit të studentëve). - Nuk ka ndonjë publikim qoftë edhe në format të përmbledhur të rezultateve të vlerësimeve të kryera nga NJSBC. - Nuk ka ndonjë shembull promovimi të praktikave pozitive me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mtejshëm në mësimdhënie. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në KUQ sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet kryesisht nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Në Statutin dhe Rregulloren e KUQ, si dhe në Rregulloren e NJSBC, përcaktohet misioni dhe funksionimi i kësaj njësie, që synon sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë, në pajtim të plotë me standardet shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë.</p> <p>[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ..pdf; An_1_3_Rregullore_e_KUQ.pdf; An_1_4_Rregullore_e_NJSBC..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; vizita në institucion]</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët	Në takimin me dy nga anëtarët e NJSBC, gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se kjo strukturë realizon aktivitetin e saj bazuar në planin vjetor të punës në përputhje me parashikimet e kuadrit rregullator të KUQ. NJSBC përbëhet nga pesë anëtarë, një prej të cilëve është student. Aktualisht tre prej anëtarëve të kësaj strukture ishin dhe anëtarë të GVB të këtij programi studimi.

<p>dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se institucioni e sheh sigurimin e brendshëm të cilësisë si pjesë përbërëse të strategjisë së zhvillimit të tij dhe nuk ka hartuar një politikë apo strategji të veçantë për të.</p> <p>KUQ ka hartuar dhe përdor një Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të rishikuar gjatë vitit 2021. Ky dokument është i organizuar në formatin e një rregulloreje, me nene specifike, që përfshijnë edhe sugjerime lidhur me rritjen dhe sigurimin e vijueshëm të cilësisë dhe zhvillimin e kurrikulave.</p> <p>GVJ konstaton që manuali përsërit një pjesë të kërkesave të kuadrit rregullator të KUQ lidhur me përgjegjësitë, funksionin dhe përbërjen e NJSBC dhe nuk ka ndonjë parashikim mbi përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në strategjinë për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: 21.Plani i aktiviteteve të zyrës NJSBC për vitin akademik 2021-2022.pdf; 11.Vendimet për emrimin e strukturave të KUQ.pdf; 17.Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>KUQ dhe programi i studimit “Master i Shkencave në Financë” i janë nënshtruar procesit të akreditimit të jashtëm në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve të kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>Akreditimi institucional i KUQ është realizuar në vitin 2018 me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.24, me kohëzgjatje prej dy vitesh dhe me rekomandime. Ndërsa ky program studimi është akredituar më 02.11.2019 me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.106, me rezultat vlerësimi “i përmbush pjesërisht standardet“ dhe me rekomandime, për realizimin e të cilave GVJ ka dhënë opinionin në hyrje të këtij raporti.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; Për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, MSc Financë, Kolegji Universitar Qirjazi]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni përdor instrumentat tradicionalë për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe problematikave në mësimdhënie dhe kërkim si: diskutimet në mbledhjet e departamentit përgjegjës për programin e studimit; tërheqjes së opinionit të studentëve përmes pyetësorëve në fund të çdo semestri nga NJSBC; si dhe mbledhje informale e opionioneve nga bizneset me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Në nivel deparamenti plotësimi i ngarkesave mësimore në bazë të aktiviteteve të parashikuara në programin mësimor dhe rezultatet e studentëve në provime, shërbejnë si tregues sasiore të ecurisë së programit të studimit.</p>

	<p>Gjithashtu, bazuar në planin vjetor të veprimtarisë së saj, NJSBC kryen kontrole dhe monitorime, të aktivitetit mësimor, të ecurisë së praktikës, të dokumentacionit etj.</p> <p>Megjithatë, GVJ nuk konstatoi ndonjë shembull promovimi të arritjeve më të mira me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie.</p> <p>[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ..pdf; An_1_3_Rregullore_e_KUQ.pdf; An_1_4_Rregullore_e_NJSBC..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; 21.Plani_i_aktiviteteve_të_zyres_NJSBC_për_vitin_akademik_2021-2022.pdf; An_3_5_Analizë_vjetore_e_Departamentit_të_Financës_(2020-2021).pdf; vizita në institucion]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në KUQ sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet kryesisht nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. - Tre nga anëtarët e NJSBC janë dhe anëtarë të GVB të këtij programi studimi. - PS është akredituar në vitin 2019 me vendimin nr.106 të Bordit të Akreditimit. - KUQ përdor instrumentat tradicionalë për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe problematikave në mësimdhënie dhe kërkim. - Nuk ka ndonjë shembull promovimi të arritjeve më të mira me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		


Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi përdorimin e pyetësorëve të studentëve si mekanizma për të siguruar informacion mbi përmbajtjen e programit të studimit dhe lëndëve, cilësinë e mësimdhënies, angazhimin e personelit akademik, si dhe infrastrukturën në dispozicion të studentëve.</p> <p>NJSBC bën përpunimin dhe analizën e pyetësorëve dhe rezultatet u komunikohen strukturave drejtuese të KUQ përmes raporteve specifike dhe raportit vjetor të veprimtarisë së NJSBC. GVJ konstaton se raportet e NJSBC janë kryesisht përshkruar të aktivitetit specifik apo veprimtarisë</p>

<p>arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>vjetore të njësisë dhe nuk përfshijnë një analizë të arritjeve/dobësive, nxitje të praktikave më të mira apo plan masash për përmirësim. Gjithashtu, në nivel njësie bazë, pranë Departamentit të Financës, përgjegjës për këtë program studimi, çdo fillim viti akademik miratohen syllabuset e lëndëve sipas programeve dhe reflektohen propozimet e pedagogëve për ndryshime në to bazuar në eksperiencën e krijuar. Mbi veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore të departamentit gjatë vitit akademik, Përgjegjësja e departamentit harton një raport i cili pas analizës në mbledhjen e departamentit u komunikohet strukturave drejtuese të KUQ. GVJ konstaton se edhe ky raport është kryesisht përshkrues i veprimtarisë së departamentit gjatë vitit akademik përkatës dhe nuk përfshin evidencë problematikash apo masa konkrete të marra në drejtim të përmirësimit të situatës.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ gjykon që kuadri rregullator i KUQ duhet të shprehet më qartë dhe në mënyrë më konkrete lidhur me përdorimin dhe dokumentimin e mekanizmave dhe proceseve formale për vlerësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: An_1_4_1_Raporti_vjetor_i_NJSBC_(2020-2021)_..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; An_3_5_Analizë_vjetore_e_Departamentit_të_Financës_(2020-2021).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në takimin me drejtuesen e departamentit dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ u informua se në KUQ përdoren disa metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit si: analiza në mbledhjet e departamentit e kalueshmërisë sipas lëndëve, rishikimi vjetor i syllabuseve, organizimi i leksioneve të hapura, vëzhgime në auditor, mbikëqyrje e grafikut të provimeve, praktikave dhe punimeve të diplomës.</p> <p>GVJ konstaton se pranë KUQ nuk mbahet ndonjë procesverbal formal lidhur me vëzhgimet e kryera përveç përfshirjes si aktivitet i realizuar në raportin e NJSBC apo në raportin vjetor të Departamentit përkatës. GVJ rekomandon që institucioni duhet të dokumentojë më mirë aktivitetet që lidhen me përdorimin e metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p><i>[Referenca: An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; 7.Procesverbal_për_kontrollin_e_veprimtarisë_mësimore nga depar.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës, GVJ konstatoi se në KUQ përdoren edhe disa teknika të tërthorta të vlerësimit si pyetësorët e studentëve për vlerësimin e procesit mësimor në fund të çdo semestri, pyetësorët për studentët që diplomohen, pyetësori për</p>

<p>tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>studentët e diplomuar (alumni), si dhe ndërton statistika mbi cilësinë në hyrje e në dalje të studentëve dhe punësimin e tyre. Megjithatë, GVJ rekomandon zgjerimin e këtyre teknikave duke përdorur edhe intervista me përfaqësues të bizneseve dhe institucioneve pranë të cilave studentët kryejnë praktikat mësimore apo mund të punësohen në të ardhmen, opinionet e të cilëve janë të rëndësishme për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>[Referenca: An_2_13_Pyetësori për studentët në FE..pdf; An_2_13_1 Pyetësori për studentet qe diplomohen..pdf; Aneks_2_13_2 Pyetësori për studentet ALUMNI..pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator i KUQ duhet të shprehet më qartë dhe në mënyrë më konkrete lidhur me përdorimin dhe dokumentimin e mekanizmave dhe proceseve formale për vlerësimin e cilësisë.</i> - <i>Në KUQ nuk mbahet ndonjë procesverbal formal lidhur me vëzhgimet e kryera përveç përfshirjes si aktivitet i realizuar në raportin e NJSBC apo në raportin vjetor të Departamentit përkatës.</i> - <i>Në KUQ nuk përdoren teknika të tërthorta të vlerësimi si intervistat me përfaqësues të bizneseve dhe institucioneve të tjera.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se kuadri rregullator kryesor i institucionit, Statuti dhe Rregullorja e KUQ, në sigurimin dhe pëmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit parashikon dhe garanton përfshirjen e strukturave si organet drejtuese të institucionit, Senatit Akademik, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Komisionin e Përheshëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, Këshillin Studentor dhe Departamentin përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu, në kuadrin rregullator të KUQ, përfshirë edhe rregulloret përkatëse të NJSBC, të FE dhe të Departamentit të Financës evidentohen detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave sipas roleve që mbulojnë lidhur me sigurimin e cilësisë në programet e studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët</p>	

<p>dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>KUQ ka hartuar dhe përdor një Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të rishikuar gjatë vitit 2021. GVJ konstaton se ky dokument është organizuar në formatin e një rregulloreje, me nene specifike, që përfshijnë edhe përgjegjësitë e strukturave të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Siç u përmend edhe në Standardin VI.3, GVJ gjykon që kuadri rregullator i KUQ duhet të shprehet më qartë dhe në mënyrë më konkrete lidhur me përdorimin dhe dokumentimin e mekanizmave dhe proceseve formale për vlerësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: An_1_1_Statuti_i_KUQ..pdf; An_1_3_Rregullore_e_Kolegjit_Universitar_„Qiriazi”_(KUQ)..pdf; An_1_4_Rregullore_e_NJSBC..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se institucioni garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit, duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p>Në takimet gjatë vizitës në KUQ, me Përgjegjësen e Departamentit dhe personelin akademik të këtij programi studimi, GVJ konstatoi angazhimin e tyre në procesin e vlerësimit të brendshëm përmes përditësimit dhe diskutimit të raporteve të vlerësimeve të bëra në mbledhjet e departamentit, si dhe përfshirjes së një personeli akademik nga departamenti si anëtar i NJSBC. Gjithashtu, në NJSBC merr pjesë edhe një student, i propozuar nga Këshilli Studentor.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë është gjithëpërfshirës dhe GVJ konstaton se pyetësorët dhe instrumentet e tjerë të përdorur në këtë proces nuk çënojnë lirinë akademike dhe integritetin akademik të personelit dhe studentëve.</p> <p>Strukturat e vlerësimit të brendshëm kujdesen që të shmangin çdo lloj diskriminimi duke ruajtur privatësinë e informacionit dhe të rezultateve që sigurojnë nga veprimtaria e tyre.</p> <p><i>[Referenca: An_1_5_Rregullore_e_Këshillit_të_Etikës..pdf; An_2_3_Rregullore_e_Fakultetit_të_Ekonomisë..pdf; An_3_0_Raporti_Vleresimi_te_Brendshem_Master_i_Shkencave_në_Financë_per_ASCAL.pdf; An_3_3_Rregullore_e_Departamentit_të_Financës..pdf; 11.Vendimet_për_krijimin_e_strukturave_të_KUQ.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KUQ ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe biznese private, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe në kuadër të konsultimeve për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofron.</p>



lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Megjithatë, GVJ nuk konstatoi ndonjë përfshirje konkrete dhe formale të bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë (nuk ka informacion mbi takimet e zhvilluara, minutat e takimit, pjesëmarrësit dhe sugjerimet e dhëna). [Referenca: An_3_0_Raporti Vlerësimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë_per ASCAL.pdf; vizita në institucion]			
Konkluzione	GVJ konstaton se: <ul style="list-style-type: none"> - Kuadri rregullator i KUQ duhet të shprehet më qartë dhe në mënyrë më konkrete lidhur me përdorimin dhe dokumentimin e mekanizmave dhe proceseve formale për vlerësimin e cilësisë. - KUQ siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. - Një anëtar i departamentit dhe një student janë pjesë e NJSBC. - Nuk ka ndonjë përfshirje konkrete dhe formale të bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se institucioni e sheh sigurimin e brendshëm të cilësisë si pjesë përbërëse të strategjisë së zhvillimit të tij dhe nuk ka hartuar një politikë apo strategji të veçantë për të. GVJ konstaton se raportet e NJBCS, përfshirë raportin vjetor, nuk janë të publikuara në faqen zyrtare web të KUQ. Por, në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se këto raporte u komunikohen të gjitha strukturave drejtuese të KUQ dhe diskutohen në të gjitha njësitë bazë. Gjithashtu, përmes personelit akademik dhe broshurave promovuese ky informacion dhe pjesë të strategjisë së zhvillimit të institucionit u bëhen të njohura edhe studentëve.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se informacioni i paraqitur në këto raporte respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe ruan privatësinë e informacionit në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale. [Referenca: An_1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"..pdf; An_1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC (2020-2021) ..pdf;

	<i>An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstatoi se në raportet e vlerësimit të NJSBC-së (raporti vjetor dhe pyetësorët e studentëve) bëhet një paraqitje përshkruese e veprimtarisë së njësisë dhe e rezultateve të pyetësorëve dhe jepen disa mendime për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe disa rekomandime për drejtuesit e KUQ.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton që raporteve u mungon një analizë konkrete, që nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta dhe që më pas mundëson nxjerrjen e përfundimeve të bazuara dhe hartimin e një plani konkret masash për përmirësim e situatës së evidentuar në raporte. Këto raporte bëhen pjesë e diskutimeve dhe analizave vjetore në të gjitha nivelet (njësie bazë, njësi kryesore dhe nivel institucioni), por GVJ vlerëson se niveli i rekomandimeve të dhëna dhe masave për përmirësimin e cilësisë duke filluar që nga njësia bazë është modest.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjithashtu, GVJ konstatoi se në mbledhjet e departamentit, personeli akademik analizon ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, në funksion të përmirësimit të cilësisë së procesit. Në planveprimin e NJSBC-së për vitin përfshihen takime dhe trajnime me personelin akademik dhe studentët me qëllim përditësimin e vijueshëm të tyre dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive në procesin e përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit. GVJ rekomandon se NJSBC duhet të strukturojë raportet e aktivitetit të vet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në standardet e cilësisë, duke përfshirë një analizë të plotë të gjetjeve që nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta dhe që mundëson nxjerrjen e përfundimeve të bazuara dhe hartimin e një plani konkret masash për përmirësim e situatës së evidentuar në raporte. [Referenca: An_1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC (2020-2021) ..pdf; An_3_0_Raporti Vleresimi te Brendshem Master i Shkencave në Financë per ASCAL.pdf; An_3_5_Analizë vjetore e Departamentit të Financës (2020-2021).pdf; 21.Plani i aktiviteteve të zyrës NJSBC për vitin akademik 2021-2022.pdf; vizita në institucion]
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Raportet e NJBCS, përfshirë raportin vjetor, nuk janë të publikuara në faqen zyrtare web të KUQ. - Raporteve u mungon një analizë konkrete, që nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta dhe që mundëson nxjerrjen e përfundimeve të bazuara dhe hartimin e një plani konkret masash për përmirësim e situatës së evidentuar në raporte.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Qirjazi”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Përgatitja dhe angazhimi i personelit akademik të programit të studimit.
2. Infrastruktura në dispozicion të studentëve krahasuar me numrin aktual të studentëve.
3. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL, brenda dhe jashtë vendit, institucione publike dhe private, shoqata profesionale dhe aktorë biznesi.

Pika të dobëta

1. Mospërputhje dhe mungesa në formë dhe në përmbajtje në RVB dhe dokumentacionin shoqërues si p.sh.:
 - a. Mësimi për vitin 2020-2021 është zhvilluar sipas programit të vjetër mësimor. Plani mësimor i programit të studimit ka ndryshuar në vitin akademik 2021-2022 dhe jo sikurse raportohet në bazë të dokumentacionit në vitin 2020-2021. [Fusha II, Standardi II.1, Standardi II.3]
 - b. Ndryshimet në programin mësimor janë më të mëdha se ndryshimet e miratura me vendim nga strukturat përgjegjëse. Ndryshimi i planit mësimor nuk lidhet vetëm me ndryshimin e krediteve (ECTS), por ka edhe ndryshime të lëndëve pothuaj në masën 50% të tyre. [Fusha II, Standardi II.1, Standardi II.3]
 - c. Rregulloret e njësisë kryesore/bazë dhe rregullorja e programit të studimit nuk kanë të përcaktuar qartë fushën akademike kryesore dhe specifike të njësive përkatëse. Objektivat formues të programit të studimit mungojnë. [Fusha II, Standardi II.6; Fusha III, Standardi III.3, Standardi III.5]
 - d. Sipas planit mësimor, lëndët e kategorisë karakterizuese përbëjnë 55% të totalit të krediteve, në përputhje me VKM nr. 41, por në këtë kategori janë përfshirë edhe lëndë që nuk lidhen drejtpërdrejt me profilin e programit të studimit si Ekonometri apo Ekonomiks Menaxherial. [Fusha II, Standardi II.3]

- e. Kriteret e pranimit në programin e studimit të përcaktuar në kuadrin rregullator të institucionit janë shumë të përgjithshme - mjafton që studenti të zotërojë një diplomë studimi "Bachelor". Ndërkohë që për një program të nivelit të dytë të studimeve Master i Shkencave, studentët duhet të kenë disa njohuri bazë të fushës së studimit të programit. *[Fusha II, Standardi II.3]*
 - f. Shumicës së dokumentacionit shoqërues, por edhe shtesë, i mungon data ose referenca kohore nuk është e qartë. *[Fusha III, Standardi III.1; Fusha IV, Standardi IV.1]*
2. Studimi i tregut i kryer për këtë program studimi është shumë i përgjithshëm dhe pothuaj i njëjtë me studimin e tregut të kryer për një program studimi të ciklit të parë të studimeve në Administrim Biznesi. *[Fusha II, Standardi II.5]*
 3. Nivel i ulët i kërkimit shkencor të lidhur me fushën e programit të studimit - financën. Përfshirje e vogël në projekte dhe aktivitete shkencore të pedagogëve të programit të studimit dhe mospërfshirje e studentëve në studime dhe analiza shkencore. *[Fusha II, Standardi II.7]*
 4. Mbivendosje e personelit akademik në struktura dhe komisione. *[Fusha II, Standardi II.2; Fusha IV, Standardi IV.1; Fusha VI, Standardi VI.2]*
 5. Numri i ulët i personelit administrativ dhe mungesa e personelit ndihmës-mësimor, pavarësisht numrit të ulët të studentëve, ndikon edhe cilësinë e shërbimeve dhe dokumentacionit të mbajtur pranë institucionit. *[Fusha II, Standardi II.2; Fusha IV, Standardi IV.1, Standardi IV.4]*
 6. Kontratat e personelit akademik me grada e tituj janë një-vjeçare, me te drejtë rinovimi, ekspozojnë institucionin ndaj rrezikut të mospërbushjes së detyrimit ligjor për numrin minimal të anëtarëve të departamentit në rast të largimit të tyre. *[Fusha II, Standardi II.2; Fusha IV, Standardi IV.1]*
 7. Institucioni ka rezultuar me humbje për tre vitet e fundit financiare, nuk kryen auditim ligjor të pavarur (të jashtëm), si dhe nuk ka një plan ekonomik-financiar të justifikuar për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen. *[Fusha IV, Standardi IV.5]*

Rekomandime

1. Institucioni duhet të rishikojë programin e studimit dhe të pasqyrojë ndryshimet në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.
2. Institucioni duhet të rishikojë dhe përditësojë rregulloret e tij (të njësisë kryesore, bazë dhe të programit të studimit) duke i plotësuar sipas objektivave përkatës (fushat akademike, objektivat e programit të studimit) dhe duke harmonizuar kërkesat në to.
3. NJSBC duhet të strukturojë raportet e aktivitetit të vet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në standardet e cilësisë, duke përfshirë një analizë të plotë të gjetjeve që nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta dhe që mundëson nxjerrjen e përfundimeve të bazuara, si dhe hartimin e një plani konkret masash për përmirësim e situatës së evidentuar në raporte.
4. Institucioni duhet të realizojë një studim tregu të dedikuar për këtë program studimi.

5. Institucioni duhet të rishikojë politikën e tij lidhur me kontratat e punësimit të personelit akademik me grada dhe tituj, për të garantuar qendrushmëri në staf.
6. Institucioni duhet të rrisë numrin e personelit ndihmës dhe të punësojë personel ndihmës – mësitor për një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe për të rritur cilësinë e shërbimit dhe të dokumentacionit të institucionit.
7. Institucioni duhet të hartojë një plan ekonomik-financiar për të forcuar situatën e tij financiare, të bazuar në analiza konkrete dhe duke përmirësuar e konsoliduar programet ekzistuese të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Finance" provided by the Higher Education Institution "Kolegji Universitar Qirjazi"

Strengths and affirmations

1. The quality and the commitment of the academic staff engaged at the study program Master of Sciences in "Finance".
2. The adequate infrastructure and facilities for effective teaching and learning, given the current number of students.
3. The KUQ has agreements signed with higher education institutions, national and international, with other public and private institutions, with professional associations and with business partners.

Weaknesses

1. Inconsistencies and deficiencies, formal and substantive, in the RVB and accompanying documentation, such as:
 - a. The teaching at study program for the academic year 2020-2021 has been developed according to the old curriculum. It results that the curriculum of the study program has changed in the academic year 2021-2022 and not in the year 2020-2021, as reported on RVB and on the accompanying documentation. [Chapter II, Standard II.1, Standard II.3]
 - b. The changes in the curriculum are greater than the changes approved by the decision of the responsible structures. Curriculum changes are not only related to the changes of credits (ECTS), but there are also changes of subjects in nearly 50% of them. [Chapter II, Standard II.1, Standard II.3]
 - c. The core regulations do not clearly define the main and specific academic field of the faculty, of the department, and of the study program. The formative objectives of the study program are also missing. [Chapter II, Standard II.6; Chapter III, Standard III.3, Standard III.5]
 - d. According to the curriculum, the subjects of the characterizing category constitute 55% of the total credits (ECTS), in accordance with VKM no. 41, but this category also includes subjects that are not directly related to the profile of the study program, such as Econometrics or Managerial Economics. [Chapter II, Standard II.3]
 - e. The admission criteria to the study program defined in the institution's regulatory framework are very broad – "it is sufficient for the student to possess a Bachelor's degree". Meanwhile for a second-level Master of Science program, students must have some basic knowledge of the program's field of study. [Chapter II, Standard II.3]
 - f. Most of the accompanying documentation, but also additional one, has no date or the time reference is not clear. [Chapter III, Standard III.1; Chapter IV, Standard IV.1]
2. The market study conducted for this study program is very general and almost the same as the market study conducted for another study program of the first cycle of studies in Business Administration. [Chapter II, Standard II.5]

3. Low level of scientific research related to the field of finance – the field of the study program. Little involvement in scientific projects and activities of academic staff of this study program and non-involvement of students in scientific studies and analysis. [Chapter II, Standard II.7]
4. Overlap of academic staff in structures and commissions within KUQ. [Chapter II, Standard II.2; Chapter IV, Standard IV.1; Chapter VI, Standard VI.2]
5. The low number of administrative staff and the lack of support-teaching staff, despite the low number of students, also affects the quality of services and documentation prepared and kept at the institution. [Chapter II, Standard II.2; Chapter IV, Standard IV.1, Standard IV.4]
6. Contracts for senior academic staff are for one year, with the right to renew, exposing the institution to the risk of not complying with the legal obligation for the minimum number of members of the department in the event of the departure of one of them. [Chapter II, Standard II.2; Chapter IV, Standard IV.1]
7. The institution has closed the last three years at a loss, has not carried out an independent (external) statutory audit and does not have a justified financial plan to improve the financial situation in the future. [Chapter IV, Standard IV.5]

Recommendation

1. The institution should review the study program and reflect the changes as required by the current legal and regulatory framework.
2. The institution should review and update its own regulatory framework (regulation of the faculty, regulation of the department, and that of the study program) by completing it with the relevant objectives (academic fields, study program objectives) and harmonizing the requirements set out therein.
3. The NJSBC should structure its activity reports in accordance with the requirements set out in the quality standards, including a thorough analysis of the results highlighting the strengths and weaknesses and allowing for well-founded conclusions, and the development of a plan of measures concrete to improve the situation identified in their reports.
4. The institution should carry out a customized market research for this study program.
5. The institution should review its policy regarding the employment contracts of senior academic staff, to ensure staff stability.
6. The institution should increase the number of administrative staff and hire support-teaching staff for a clear division of tasks and responsibilities, as well as to increase the quality of service and documentation of the institution.
7. The institution should draw up an economic-financial plan to strengthen its financial situation, based on concrete analyzes, and on the improvement and consolidation of the existing study programs.

Fulfillment of quality standards of the program

EVALUATION AREA	FULFILLMENT OF STANDARDS FOR EACH AREA			
	Not Met	Partially Met	Substantially Met	Met
I. STUDY PROGRAM PROVISION			X	
II. STUDY PROGRAM ORGANIZATION, MANAGEMENT AND ADMINISTRATION			X	
III. TEACHING, LEARNING, ASSESMENT AND COMPETENCIES			X	
IV. HUMAN, FINANCIAL, INFRASTRUCTURE, AND LOGISTICS RESOURCES FOR STUDY PROGRAM DELIVERY			X	
V. STUDENTS AND THEIR SUPPORT				X
VI. STUDY PROGRAM QUALITY ASSURANCE			X	
TOTAL EVALUATION			X	

